

L I G J I

PËR ZGJEDHJEN E DEPUTETËVE POPULLORË¹

I DISPOZITAT THEMELORE

Objekti i ligjit

Neni 1

Ky ligj rregullon zgjedhjen dhe ndërprerjen e mandatit të deputetëve popullorë të Ansamblesë Popullore (në tekstin e mëtejshëm: deputetët popullorë).

Ansambleja Popullore ka 250 deputetë popullorë, të cilët zgjidhen për katër vjet.

Parimet themelore të zgjedhjeve për deputetët popullorë

Neni 2

Qytetarët zgjedhin deputetët popullorë në bazë të së drejtës së përgjithshme dhe të barabartë elektorale.

Zgjedhjet për deputetë popullorë janë të lira dhe të drejtpërdrejta, dhe votimi është i fshehtë dhe personal.

E drejta elektorale

Neni 3

Të drejtën për të zgjedhur deputetët popullorë dhe për t'u zgjedhur deputet popullor e ka shtetasi i rritur i Republikës së Serbisë mbi të cilin nuk është zgjatur e drejta prindërore, përkatësisht i cili nuk është privuar nga aftësia për të punuar.

Personi pjesërisht i privuar nga aftësia për të punuar mund të zgjedhë deputetët popullorë dhe të zgjidhet për deputet popullor nëse gjykata nuk përcaktoi me vendim për privimin e pjesësisht të aftësisë për të punuar që ai është i paaftë për të ushtruar të drejtën elektorale.

Liria e votimit

Neni 4

Votuesi është i lirë të vendosë nëse do të votojë dhe si do të votojë.

Askush nuk ka të drejtë që ta pengojë ose të detyrojë votuesin të votojë, ta thërrasë atë në përgjegjësi sepse votoi ose nuk votoi dhe t'i kërkojë atij të deklarohet kë e votoi ose pse nuk votoi.

E drejta e barabartë elektorale dhe sistemi proporcional zgjedhor

Neni 5

Votuesi ka vetëm një votë.

Votohet për listën zgjedhore të kandidatëve për deputetë popullorë (në tekstin e mëtejshëm: lista zgjedhore).

Deputetët popullorë zgjidhen në Republikën e Serbisë si një njësi zgjedhore.

Mandatet e deputetëve u shpërndahen listave zgjedhore në përpjesëtim me numrin e votave të marra, dhe numri i mandateve të cilat u përkasin listave zgjedhore përcaktohet duke zbatuar sistemin e koeficientit më të lartë.

¹ „Fletorja zyrtare RS“, numri 14/22

Mandatet e deputetëve të fituara nga lista zgjedhore u jepen kandidatëve për deputetët popullorë sipas rendit të tyre në listën zgjedhore.

Njoftimi për zgjedhjet

Neni 6

Qytetarët kanë të drejtë që të informohen, përmes serviseve publike mediatike, rreth programeve dhe aktiviteteve zgjedhore të paraqitësve të listave zgjedhore, si dhe rreth kandidatëve për deputetë popullorë në përputhje me dispozitat që rregullojnë serviset publike mediatike dhe mediat elektronike.

Gjatë fushatës zgjedhore, ofruesi i shërbimit mediatik është i detyruar t'u sigurojë përfaqësim pa diskriminim paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore dhe kandidatëve për deputetë popullorë, në përputhje me dispozitat që rregullojnë serviset mediatike publike dhe mediat elektronike.

48 orë para ditës së votimit dhe në ditën e votimit deri në mbylljen e vendotimeve ndalohet publikimi në media dhe në tubimet publike i vlerësimeve të rezultateve të zgjedhjeve, prezantimi publik i kandidatëve në zgjedhjet për deputetë popullorë dhe programeve të tyre zgjedhore si dhe thirrja e votuesve që të votojnë, përkatësisht që të mos votojnë për lista të caktuara zgjedhore.

Në kuptimin e këtij ligji, termi "media" nënkupton gazetat ditore dhe periodike, shërbimin e agjencisë së lajmeve, programet radio-televizive dhe edicionet elektronike të atyre mediave, si dhe edicionet e pavarura elektronike (faqet e internetit ose portalet e internetit të formuara në mënyrë redaktuese), të cilat janë regjistruar në Regjistrin e mediave, në përputhje me ligjin.

II ORGANET E ZBATIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR DEPUTETËT POPULLORË

1. Rregullat e përbashkëta për organet e zbatimit të zgjedhjeve

Kompetenca për zbatimin e zgjedhjeve për deputetët popullorë

Neni 7

Zgjedhjet për deputetët popullorë (në tekstin e mëtejshëm: zgjedhjet) zbatohen nga Komisioni Zgjedhor i Republikës, komisioni zgjedhor lokal dhe këshillat e vendvotimit.

Rregullat e përgjithshme për pozitën e organeve të zbatimit të zgjedhjeve

Neni 8

Organet e zbatimit të zgjedhjeve janë të pavarura dhe punojnë në bazë të ligjeve dhe dispozitave të miratuara në bazë të ligjit.

Organet e zbatimit të zgjedhjeve i përgjigjen për punën e tyre organit i cili i ka formuar.

Puna e organit të zbatimit të zgjedhjeve është publike.

Në punën e organit të zbatimit të zgjedhjeve nuk mund të marrë pjesë një kandidat për deputet popullor.

Kushtet e punës së organeve për zbatimin e zgjedhjeve sigurohen nga Ansambleja Popullore dhe administrata komunale, përkatësisht e qytetit.

Të gjitha organet dhe organizatat shtetërore dhe të tjera janë të detyruara t'u ofrojnë ndihmë organeve të zbatimit të zgjedhjeve dhe t'u dorëzojnë atyre të dhënat e nevojshme për punë.

Anëtari dhe zëvendës anëtari në organin e zbatimit të zgjedhjeve

Neni 9

Organi për zbatimin e zgjedhjeve përbëhet nga kryetari dhe anëtarët e tjera të organit për zbatimin e zgjedhjeve dhe zëvendësit e tyre.

Personi i njëjtë mund të emërohet disa herë në organin e zbatimit të zgjedhjeve.

Zëvendës anëtari i organit për zbatimin e zgjedhjeve ka të drejtat dhe detyrat e njëjta si dhe anëtari të cilin e zëvendëson.

Zëvendës anëtari i organit për zbatimin e zgjedhjeve ka të drejtën e votës vetëm kur mungon anëtari të cilin e zëvendëson.

Organi i zbatimit të zgjedhjeve mund të autorizojë anëtarin e vet, përkatësisht zëvendës anëtarin që, në emër të atij organi të zbatimit të zgjedhjeve, të kryejë punët e caktuara lidhur me organizimin, përgatitjen dhe zbatimin e zgjedhjeve, përkatësisht votimin.

Organi i zbatimit të zgjedhjeve në përbërje të përhershme dhe të zgjeruar

Neni 10

Organi i zbatimit të zgjedhjeve punon në përbërje të përhershme dhe të zgjeruar.

Paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore ka të drejtë që të propozojë një anëtar dhe zëvendës anëtar të organit për zbatimin e zgjedhjeve në përbërje të zgjeruar.

Nëse paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore nuk propozon një anëtar, përkatësisht një zëvendës anëtar të organit për zbatimin e zgjedhjeve në përbërje të zgjeruar brenda afatit të përcaktuar me ligj, organi vazhdon punën dhe merr vendime të plotfuqishme pa përfaqësuesin e atij paraqitësi të listës zgjedhore.

Anëtari, përkatësisht zëvendës anëtari i organit për zbatimin e zgjedhjeve në përbërje të zgjeruar ka të drejtat dhe detyrat e njëjta si dhe anëtari, përkatësisht zëvendës anëtari në përbërje të përhershme.

Rregullat e përgjithshme për propozimin e anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve në organet e zbatimit të zgjedhjeve

Neni 11

Kur propozuesit e autorizuar propozojnë anëtarët dhe zëvendës anëtarët në organet e zbatimit të zgjedhjeve, duhet të kujdesen për përfaqësimin e balancuar të gjinive dhe nevojën për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në zbatimin e procedurës zgjedhore.

Propozimi për emërimin e anëtarit dhe zëvendës anëtarit të organit për zbatimin e zgjedhjeve përmban emrin dhe mbiemrin, numrin personal të identifikimit (në tekstin e mëtejshëm: JMBG), vendin dhe adresën e vendbanimit, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike të anëtarit të propozuar, përkatësisht të zëvendës anëtarit dhe shenjën e grupit parlamentar në Ansamblenë Popullore (në tekstin e mëtejshëm: grupi parlamentar) ose të një propozuesi tjetër të autorizuar.

Vendimmarrja e organeve për zbatimin e zgjedhjeve

Neni 12

Organi për zbatimin e zgjedhjeve vendos me shumicë të numrit të përgjithshëm të votave të anëtarëve në përbërje të përhershme, përkatësisht të zgjeruar.

Kushti për anëtarësinë në organin e zbatimit të zgjedhjeve

Neni 13

Si anëtar dhe zëvendës anëtar i organit të zbatimit të zgjedhjeve mund të emërohet vetëm ai person i cili ka të drejtën elektorale dhe nuk është as deputet popullor, as kandidat për deputet popullor.

Ndërprerja e funksionit në organin e zbatimit të zgjedhjeve

Neni 14

Funksioni i anëtarit dhe zëvendës anëtarit të organit për zbatimin e zgjedhjeve ndërpritet sipas fuqisë së ligjit, dhe organi kompetent për emërimin e tij e përcakton sipas detyrës zyrtare ndërprerjen e funksionit të tij:

- 1) nëse vdes;
- 2) nëse humb të drejtën elektorale;
- 3) kur të shpallet lista zgjedhore në të cilën është kandidat për deputet popullor
- 4) nëse paraqitësi i listës zgjedhore i cili e propozoi atë e tërheq listën zgjedhore;
- 5) nëse anulohet vendimi për shpalljen e listës zgjedhore paraqitësi i së cilës e propozoi atë;
- 6) nëse është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me burgim prej të paktën gjashtë muajsh;
- 7) nëse humb aftësinë për të punuar;
- 8) në raste të tjera të parashikuara në ligj.

Anëtarin, përkatësisht zëvendës anëtarin i organit për zbatimin e zgjedhjeve zgjidhet nga detyra nga organi kompetent për emërimin e tij:

- 1) nëse jep dorëheqjen me shkrim;
- 2) nëse konstatohet më vonë se nuk përmbush kushtin e veçantë për emërim;
- 3) në raste të tjera të parashikuara me këtë ligj.

Me hyrjen në fuqi të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve, Komisioni Zgjedhor i Republikës është i detyruar ta zgjidhë nga detyra anëtarin dhe zëvendës anëtarin e Komisionit Zgjedhor të Republikës dhe të komisionit zgjedhor lokal në përbërje të përhershme, të vërtetojë se funksioni i tij është ndërprerë sipas fuqisë së ligjit, si dhe ta emërojë me propozim të propozuesit të autorizuar anëtarin e ri në vend të atij të zgjidhur, përkatësisht të cilit i ka mbaruar funksioni sipas fuqisë së ligjit.

Vendimi i organit për zbatimin e zgjedhjeve nuk mund të kontestohet në bazë të mosvendimmarrjes së organit në përbërjen e parashikuar nëse mjeti i parashikuar juridik nuk është paraqitur në kohë për të kontestuar përbërjen e tij.

Rasti i veçantë i ndërprerjes së funksionit

Neni 15

Personi i njëjtë nuk mund të jetë anëtar i dy organeve për zbatimin e zgjedhjeve.

Nëse është emëruar një person në disa organe për zbatimin e zgjedhjeve, sipas fuqisë së ligjit i ndërpritet funksioni në atë organ në të cilin është emëruar më vonë.

2 Komisioni Zgjedhor i Republikës

Kushti i veçantë për emërimin e anëtarit dhe zëvendës anëtarit të Komisionit Zgjedhor të Republikës

Neni 16

Si anëtar dhe zëvendës anëtar i Komisionit Zgjedhor të Republikës mund të emërohet vetëm ai person i cili ka arsim të lartë në fushën e shkencave juridike.

Komisioni Zgjedhor i Republikës në përbërje të përhershme

Neni 17

Komisioni Zgjedhor i Republikës në përbërje të përhershme përbëhet nga një kryetar, 16 anëtarë, një zëvendëskryetar dhe 16 zëvendës anëtarë, të cilët emërohen nga Ansambleja Popullore.

Vendimi për emërimin e përbërjes së përhershme të Komisionit Zgjedhor të Republikës publikohet në "Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë".

Mandati i përbërjes së përhershme të Komisionit Zgjedhor të Republikës përfundon kur legjislatura e re e Ansamblesë Popullore emëron përbërjen e re të përhershme të Komisionit Zgjedhor të Republikës.

Legjislatura e re e Ansamblesë Popullore është e detyruar të emërojë përbërjen e re të përhershme të Komisionit Zgjedhor të Republikës brenda 6 muajve nga dita e konstituimit të Ansamblesë Popullore.

Propozuesi i autorizuar për emërimin e anëtarit dhe zëvendës anëtarit të Komisionit Zgjedhor të Republikës në përbërje të përhershme

Neni 18

Anëtarët dhe zëvendës anëtarët e Komisionit Zgjedhor të Republikës në përbërje të përhershme emërohen me propozim të grupeve parlamentare në përpjesëtim me përfaqësimin e tyre në numrin e përgjithshëm të deputetëve popullorë të cilët u përkasin grupeve parlamentare.

Asnjëri grup parlamentar nuk mund të propozojë më shumë se gjysmën e anëtarëve të Komisionit Zgjedhor të Republikës në përbërje të përhershme.

Grupi parlamentar i cili ka më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të deputetëve popullorë propozon kryetarin, zëvendëskryetarin, shtatë anëtarë dhe shtatë zëvendës anëtarë të Komisionit Zgjedhor të Republikës në përbërje të përhershme, ndërsa anëtarët dhe zëvendës anëtarët e tjerë në Komisionin Zgjedhor të Republikës në përbërje të përhershme propozohen nga grupet e tjera parlamentare në përpjesëtim me përfaqësimin e tyre në numrin e përgjithshëm të deputetëve popullorë që u përkasin grupeve parlamentare.

Si grup parlamentar, në kuptim të propozimit të anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve të Komisionit Zgjedhor të Republikës në përbërje të përhershme, konsiderohet edhe një deputet popullor individual ose një grup deputetësh popullorë që është më i vogël se numri i deputetëve popullorë të nevojshëm për formimin e grupit parlamentar:

1) nëse të gjithë ata deputetë popullorë janë zgjedhur nga lista e njëjtë zgjedhore;

2) nëse lista zgjedhore në të cilën janë zgjedhur nuk fitoi aq mandate sa është e nevojshme për formimin e grupit parlamentar;

3) nëse askush prej tyre nuk hyri në ndonjë grup parlamentar;

4) nëse të gjithë ata deputetë popullorë kanë nënshkruar propozimin për emërimin e anëtarit, përkatësisht të zëvendës anëtarit të Komisionit Zgjedhor të Republikës në përbërje të përhershme.

Përfaqësimi gjinor në Komisionin Zgjedhor të Republikës në përbërje të përhershme

Neni 19

Grupi parlamentar, që ka të drejtë të propozojë dy persona në përbërjen e përhershme të Komisionit Zgjedhor të Republikës, është i detyruar të propozojë nga një pjesëtar nga secila gjini.

Grupi parlamentar, që ka të drejtë të propozojë tre persona në përbërjen e përhershme të Komisionit Zgjedhor të Republikës, është i detyruar të propozojë dy pjesëtarë nga njëra gjini dhe një pjesëtar nga gjinia tjetër.

Grupi parlamentar, që ka të drejtë të propozojë katër persona në përbërjen e përhershme të Komisionit Zgjedhor të Republikës, është i detyruar të propozojë nga dy pjesëtarë nga të dyja gjini.

Grupi parlamentar, që ka të drejtë të propozojë pesë persona në përbërjen e përhershme të Komisionit Zgjedhor të Republikës, është i detyruar të propozojë tre pjesëtarë nga njëra gjini dhe dy pjesëtarë nga gjinia tjetër.

Propozimi i grupit parlamentar që ka të drejtë të propozojë më shumë se pesë persona në përbërjen e përhershme të Komisionit Zgjedhor të Republikës duhet të përmbajë të paktën 40% e pjesëtarëve nga gjinia më pak e përfaqësuar ndër personat e propozuar.

Ankesa kundër vendimit për emërimin e anëtarit dhe zëvendës anëtarit të Komisionit Zgjedhor të Republikës në përbërje të përhershme

Neni 20

Kundër vendimit për emërimin e anëtarit dhe zëvendës anëtarit të Komisionit Zgjedhor të Republikës në përbërje të përhershme, secili paraqitës i listës së shpallur zgjedhore, e cila ka fituar mandate në legjislaturën aktuale të Ansamblesë Popullore, dhe secili votues mund t'i paraqesin ankesën Gjykatës Administrative përmes Ansamblesë Popullore brenda shtatë ditëve nga dita e publikimit të tij në "Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë."

Ansambleja Popullore është i detyruar t'i paraqesë Gjykatës Administrative ankesën dhe të gjitha dosjet e çështjes brenda 24 orëve nga marrja e ankesës.

Gjykata Administrative merr vendim sipas ankesës brenda shtatë ditëve nga marrja e ankesës me shkresat.

Vendimi i marrë sipas ankesës në procedurë është i plotfuqishëm dhe kundër tij nuk mund të paraqiten mjetet e jashtëzakonshme juridike të parashikuara me ligjin me të cilin rregullohet kontesti administrativ.

Pjesëmarrësit në punën e Komisionit Zgjedhor të Republikës pa të drejtë vendimmarrjeje

Neni 21

Pjesëmarrësit në punën e Komisionit Zgjedhor të Republikës pa të drejtë vendimmarrjeje janë sekretari i Komisionit Zgjedhor të Republikës, zëvendëssekretari i Komisionit Zgjedhor të Republikës dhe dy pjesëmarrës të detyruar për punët e statistikës.

Sekretari dhe zëvendëssekretari i Komisionit Zgjedhor të Republikës emërohen nga Ansambleja Popullore me propozim të kryetarit të Ansamblesë Popullore nga radhët e punonjësve në Shërbimin e Ansamblesë Popullore.

Pjesëmarrësit e detyruar për punët e statistikës emërohen nga Ansambleja Popullore me propozim të organit kompetent të republikës për punët e statistikës.

Si pjesëmarrës në punën e Komisionit Zgjedhor të Republikës pa të drejtë vendimmarrjeje mund të emërohet vetëm ai person që ka të drejtën elektorale dhe nuk është deputet popullor ose kandidat për deputet popullor.

Si sekretar dhe zëvendëssekretar i Komisionit Zgjedhor të Republikës mund të emërohet vetëm personi me arsim të lartë në fushën e shkencave juridike.

Dispozitat e këtij ligji, me të cilat rregullohet ndërprerja e funksionit në organin e zbatimit të zgjedhjeve, zbatohen edhe mbi pjesëmarrësit në punën e Komisionit Zgjedhor të Republikës pa të drejtë vendimmarrjeje.

Komisioni Zgjedhor i Republikës në përbërje të zgjeruar

Neni 22

Anëtari dhe zëvendës anëtari i Komisionit Zgjedhor të Republikës në përbërje të zgjeruar emërohen nga Komisioni Zgjedhor i Republikës me propozim të paraqitësit të listës së shpallur zgjedhore, dhe ky propozim duhet të dorëzohet jo më vonë se shtatë ditë para ditës së votimit.

Komisioni Zgjedhor i Republikës është i detyruar të marrë vendim rreth propozimit për emërimin e anëtarit dhe zëvendës anëtarit të Komisionit Zgjedhor të Republikës në përbërje të zgjeruar brenda 24 orëve nga marrja e propozimit.

Zbatimi i vendimit për emërimin e anëtarit dhe zëvendës anëtarit të Komisionit Zgjedhor të Republikës në përbërje të zgjeruar fillon një ditë pas miratimit.

Anëtari, përkatësisht zëvendës anëtari i Komisionit Zgjedhor të Republikës në përbërje të zgjeruar i cili është shkarkuar, përkatësisht të cilit i është ndërprerë funksioni sipas fuqisë së ligjit, mund të zëvendësohet me kërkesë të paraqitësit të listës së shpallur zgjedhore, me propozimin e të cilit është emëruar vetëm derisa Komisioni Zgjedhor i Republikës punon në përbërje të zgjeruar.

Komisioni Zgjedhor i Republikës punon në përbërje të zgjeruar derisa të bëhet përfundimtar raporti i përgjithshëm për rezultatet e zgjedhjeve.

Kundërshtimi ndaj vendimit për propozimin e emërimit të anëtarit dhe zëvendës anëtarit të Komisionit Zgjedhor të Republikës në përbërje të zgjeruar

Neni 23

Ndaj vendimit me të cilin është refuzuar propozimi për emërimin e anëtarit dhe zëvendës anëtarit të Komisionit Zgjedhor të Republikës në përbërje të zgjeruar, paraqitësi i propozimit mund t'i paraqesë kundërshtim Komisionit Zgjedhor të Republikës brenda 48 orëve nga publikimi i këtij vendimi në ueb-faqe të Komisionit Zgjedhor të Republikës (në tekstin e mëtejshëm: ueb-faqe)

Kundër vendimit për emërimin e anëtarit dhe zëvendës anëtarit të Komisionit Zgjedhor të Republikës në përbërje të zgjeruar, paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore, partia e regjistruar politike dhe votuesi mund t'i paraqesin kundërshtim Komisionit Zgjedhor të Republikës brenda 48 orëve nga publikimi i atij vendimi në ueb-faqe.

Kompetenca e Komisionit Zgjedhor të Republikës

Neni 24

Komisioni Zgjedhor i Republikës

- 1) kujdeset për zbatimin e ligjshëm të zgjedhjeve;
- 2) përcakton udhëzimet e zbatimit të veprimeve zgjedhore;
- 3) publikon listën e afateve për kryerjen e veprimeve zgjedhore;
- 4) përcakton formularët për zbatimin e veprimeve zgjedhore;
- 5) monitoron zbatimin dhe jep mendime lidhur me zbatimin e këtij ligji;
- 6) emëron, shkarkon dhe konstaton ndërprerjen e funksionit të anëtarit dhe zëvendës anëtarit të organeve për zbatimin e zgjedhjeve, në përputhje me këtë ligj;
- 7) përcakton standardet unike për materialin zgjedhor;
- 8) siguron materialin zgjedhor për zbatimin e zgjedhjeve;
- 9) përcakton mënyrën e dorëzimit të materialit zgjedhor para dhe pas votimit;
- 10) përcakton vendvotimet, në përputhje me këtë ligj;
- 11) merr vendim për listën e dorëzuar zgjedhore;
- 12) përpilon dhe publikon manualin për zbatimin praktik të rregullave që rregullojnë mënyrën e zbatimit të votimit nga këshillat e vendvotimit dhe përcakton rezultatet e votimit në një vendvotim;
- 13) përcakton mënyrën e monitorimit të pjesëmarrjes së votuesve në votim;
- 14) përcakton programet e trajnimit dhe zbaton trajnimet e anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve të komisioneve zgjedhore lokale dhe këshillave zgjedhorë;
- 15) informon dhe edukon votuesit për mënyrën e realizimit të së drejtës elektorale, si edhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurën zgjedhore;
- 16) merr vendime për kundërshtimet, në përputhje me këtë ligj;
- 17) përcakton më hollësisht mënyrën e paraqitjes së kundërshtimit dhe veprimin sipas kundërshtimeve në Komisionin Zgjedhor të Republikës;
- 18) konstaton rezultatet e zgjedhjeve, sjell dhe publikon raportin e përgjithshëm të rezultateve të zgjedhjeve;
- 19) harmonizon dhe monitoron punën e organeve për zbatimin e zgjedhjeve;
- 20) përcakton kodin e sjelljes së anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve të organit për zbatimin e zgjedhjeve;
- 21) i paraqet Ansamblesë Popullore raportin për zgjedhjet e zbatuara;
- 22) ushtron edhe punët e tjera të parashikuara me këtë ligj.

Duke mbikëqyrur punën e komisioneve zgjedhore lokale, Komisioni Zgjedhor i Republikës është i autorizuar që, sipas detyrës zyrtare, të anulojë vendimin e komisionit zgjedhor lokal i cili është marrë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Komisioni Zgjedhor i Republikës përcakton formularët e nevojshëm për paraqitjen e listës zgjedhore brenda tri ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve.

Komisioni Zgjedhor i Republikës miraton rregulloren e tij.

Udhëzimet për zbatimin e veprimeve zgjedhore dhe Rregullorja e punës së Komisionit Zgjedhor të Republikës publikohen në "Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë".

Publikimi i vendimeve të Komisionit Zgjedhor të Republikës

Neni 25

Vendimet e Komisionit Zgjedhor të Republikës publikohen në ueb-faqe pa vonesë, dhe jo më vonë se 24 orë nga përfundimi i seancës në të cilën janë marrë vendimet.

Në ueb-faqe duhet të shënohen data dhe koha e publikimit të vendimit.

Vendimet e Komisionit Zgjedhor të Republikës publikohen në "Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë" kur kjo parashikohet në ligj.

Pas marrjes dhe publikimit të vendimit sipas kërkesës, Komisioni Zgjedhor i Republikës është i detyruar ta njoftojë me telefon ose e-mail paraqitësin e kërkesës se vendimi sipas kërkesës së tij është marrë dhe publikuar në ueb-faqe.

Nëse është marrë sipas kërkesës vendimi i Komisionit Zgjedhor të Republikës, paraqitësi i kërkesës mund të kërkojë që një kopje me shkrim e atij vendimi t'i dorëzohet atij në selinë e Komisionit Zgjedhor të Republikës ose t'i dërgohet me postë.

Koha kur është njoftuar me telefon ose e-mail paraqitësi se është marrë dhe publikuar vendimi sipas kërkesës së tij, përkatësisht koha kur i është dorëzuar atij një kopje me shkrim e vendimit në selinë e Komisionit Zgjedhor të Republikës ose i është dërguar me postë, nuk ndikon në llogaritjen e afatit brenda të cilit mund paraqesë mjete juridike kundër atij vendimi.

Transparenca e punës së Komisionit Zgjedhor të Republikës

Neni 26

Puna e Komisionit Zgjedhor të Republikës është publike.

Transparenca e punës së Komisionit Zgjedhor të Republikës sigurohet në mënyrë që Komisioni Zgjedhor i Republikës transmeton në ueb-faqe seancat dhe konferencat e tij për mediat dhe publikon procesverbalet e seancave të tij, siguron për mjetet e informimit publik sinjalin audio dhe video i cili u mundëson transmetimin e seancës së tij, ua mundëson organizatave dhe shoqatave (vëzhguesve) të interesuar vendas, të huaj dhe ndërkombëtarë monitorimin e punës së tij edhe në mënyra të tjera në përputhje me ligjin dhe Rregulloren e punës së Komisionit Zgjedhor të Republikës.

3 Komisioni zgjedhor lokal

Komisioni zgjedhor lokal në përbërje të përhershme

Neni 27

Komisionet zgjedhore lokale janë komisionet zgjedhore komunale, komisionet zgjedhore të qytetit dhe komisionet zgjedhore të komunave të Qytetit të Beogradit.

Komisioni zgjedhor lokal në përbërje të përhershme emërohet në përputhje me ligjin me të cilin rregullohen zgjedhjet lokale.

Nëse ndryshohen grupet parlamentare pas shpalljes së zgjedhjeve, kuvendi komunal, komunat, përkatësisht komunat e qytetit nuk mund ta emërojnë para përfundimit të zgjedhjeve komisionin e ri zgjedhor lokal.

Rasti i veçantë i formimit të komisionit zgjedhor lokal në përbërje të përhershme

Neni 28

Nëse në ditën e hyrjes në fuqi të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve në kuvendin e qytetit, përkatësisht të komunës nuk ekziston komisioni zgjedhor lokal, Komisioni Zgjedhor i Republikës e themelon brenda shtatë ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve një komision zgjedhor lokal në përbërje të përhershme si organ të zbatimit të zgjedhjeve për territorin e atij qyteti, përkatësisht të komunës.

Komisioni zgjedhor lokal në përbërje të përhershme të cilin e formon Komisioni Zgjedhor i Republikës ka një kryetar, gjashtë anëtarë dhe zëvendësit e tyre, të cilët emërohen me propozim të grupeve parlamentare në përpjesëtim me përfaqësimin e tyre në Ansamblenë Popullore, në ditën kur hyri në fuqi vendimi për shpalljen e zgjedhjeve.

Grupi parlamentar i cili ka më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të deputetëve popullorë, propozon kryetarin, nënkryetarin, dy anëtarë dhe dy zëvendës anëtarë të komisionit zgjedhor lokal në përbërje të përhershme të cilin e formon Komisioni Zgjedhor i Republikës, ndërsa anëtarët dhe zëvendës anëtarët e tjerë në komisionin zgjedhor lokal në përbërje të përhershme propozohen nga grupet e tjera parlamentare në përpjesëtim me përfaqësimin e tyre në numrin e përgjithshëm të deputetëve popullorë të cilët u përkasin grupeve parlamentare.

Komisioni Zgjedhor i Republikës mund t'ia besojë komisionit zgjedhor lokal në përbërje të përhershme të cilin e formon me vendimin e tij, kompetencën për disa njësi të vetëqeverisjes lokale në të cilat nuk ka komisione zgjedhore lokale.

Si kryetar dhe nënkryetar i komisionit zgjedhor mund të emërohet vetëm një person me arsim të lartë në fushën e shkencave juridike.

Me rastin e formimit të komisionit zgjedhor lokal në përbërje të përhershme, Komisioni Zgjedhor i Republikës e emëron me propozim të kryetarit të rrethit administrativ sekretarin dhe zëvendëssekretarin e komisionit zgjedhor lokal në përbërje të përhershme, të cilët marrin pjesë në punën e tij pa të drejtë vendimmarrjeje.

Si sekretar dhe zëvendëssekretar i komisionit zgjedhor lokal mund të emërohet vetëm një person me arsim të lartë në fushën e shkencave juridike.

Propozimi i anëtarit dhe zëvendës anëtarit të komisionit zgjedhor lokal në përbërje të përhershme

Neni 29

Si grup parlamentar në kuptim të propozimit të anëtarit dhe zëvendës anëtarit të komisionit zgjedhor lokal në përbërje të përhershme të cilin e formon Komisioni Zgjedhor i Republikës konsiderohet edhe një deputet popullor individual ose një grup deputetësh popullorë që ka më pak deputetë popullorë se sa është numri i nevojshëm i deputetëve popullorë për formimin e grupeve parlamentare:

1) nëse të gjithë ata deputetë popullorë janë zgjedhur nga lista e njëjtë zgjedhore;

2) nëse lista zgjedhore në të cilën janë zgjedhur nuk fitoi aq mandate sa është e nevojshme për formimin e grupit parlamentar;

3) nëse askush prej tyre nuk hyri në ndonjë grup parlamentar;

4) nëse të gjithë ata deputetë popullorë kanë nënshkruar propozimin për emërimin e anëtarit, përkatësisht zëvendës anëtarit të komisionit zgjedhor lokal në përbërje të përhershme.

Me qëllim të formimit të komisionit zgjedhor lokal në përbërje të përhershme, Komisioni Zgjedhor i Republikës e përcakton dhe publikon në kohë në ueb-faqe listën e vendeve në bazë të së cilës grupet parlamentare propozojnë anëtarët dhe zëvendës anëtarët e atij komisioni zgjedhor lokal.

Nëse grupi parlamentar nuk e dorëzon në kohë të duhur propozimin për emërimin e anëtarit, përkatësisht të zëvendës anëtarit të komisionit zgjedhor lokal në përbërje të përhershme, Komisioni Zgjedhor i Republikës e emëron në komisionin zgjedhor lokal në përbërje të përhershme personin e propozuar nga kryetari i rrethit administrativ.

Kur propozon kandidatin për anëtar, zëvendës anëtar, sekretar dhe zëvendëssekretar të komisionit zgjedhor lokal, propozuesi i autorizuar, nëse është e mundur, i jep përparësi personit i cili është trajnuar për të punuar në komisionin zgjedhor lokal dhe i cili ka përvojë në zbatimin e zgjedhjeve.

Komisioni zgjedhor lokal në përbërje të zgjeruar

Neni 30

Anëtari dhe zëvendës anëtari i komisionit zgjedhor lokal në përbërje të zgjeruar emërohen nga komisioni zgjedhor lokal me propozim të paraqitësit të listës së shpallur zgjedhore, i cili duhet të dorëzohet jo më vonë se shtatë ditë para ditës së votimit.

Komisioni zgjedhor lokal është i detyruar të marrë vendim për propozimin për emërimin e anëtarit dhe zëvendës anëtarit të komisionit zgjedhor lokal në përbërje të zgjeruar brenda 24 orëve nga marrja e propozimit.

Zbatimi i vendimit për emërimin e anëtarit dhe zëvendës anëtarit të komisionit zgjedhor lokal në përbërje të zgjeruar fillon një ditë pas miratimit.

Anëtari ose zëvendës anëtari i komisionit zgjedhor lokal në përbërje të zgjeruar i cili është shkarkuar, përkatësisht të cilit i ka pushuar funksioni sipas fuqisë së ligjit, mund të zëvendësohet me kërkesë të paraqitësit të listës së shpallur zgjedhore, me propozimin e të cilit është i emëruar vetëm ndërsa punon në përbërje të zgjeruar komisioni zgjedhor lokal.

Komisioni zgjedhor lokal punon në përbërje të zgjeruar derisa të bëhet përfundimtar raporti përmbledhës i rezultateve të votimit.

Kundërshtimi ndaj vendimit për propozimin e emërimit të anëtarit dhe zëvendës anëtarit të komisionit zgjedhor lokal në përbërje të zgjeruar

Neni 31

Kundër vendimit me të cilin është refuzuar propozimi për emërimin e anëtarit dhe zëvendës anëtarit të komisionit zgjedhor lokal në përbërje të zgjeruar, paraqitësi i propozimit mund t'i paraqesë kundërshtim Komisionit Zgjedhor të Republikës brenda 48 orëve nga publikimi i këtij vendimi në ueb-faqe.

Kundër vendimit për emërimin e anëtarit, përkatësisht të zëvendës anëtarit të komisionit zgjedhor lokal në përbërje të zgjeruar, paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore dhe votuesi mund t'i paraqesin kundërshtim Komisionit Zgjedhor të Republikës brenda 48 orëve nga publikimi i atij vendimi në ueb-faqe.

Kompetenca e komisionit zgjedhor lokal

Neni 32

Komisioni zgjedhor lokal:

- 1) organizon përgatitjen teknike për zgjedhjet;
- 2) emëron, shkarkon dhe konstaton ndërprerjen e funksionit të anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve për zbatimin e zgjedhjeve, në përputhje me këtë ligj;
- 3) përcakton vendvotimet, në përputhje me këtë ligj;
- 4) vendos rreth kërkesave për anulimin e votimit në një vendvotim për shkak të parregullsive gjatë zbatimit të votimit;
- 5) pranon materialin zgjedhor nga Komisioni Zgjedhor i Republikës dhe u dorëzon atë këshillave zgjedhorë;
- 6) merr materialin zgjedhor nga këshillat e vendvotimit pas përfundimit të votimit;
- 7) u ofron mbështetje këshillave zgjedhorë gjatë zbatimit të votimit;
- 8) njofton Komisionin Zgjedhor të Republikës për ecurinë e votimit;
- 9) sjell raportin përmbledhës për rezultatet e votimit nga vendvotimet të cilat gjenden në territorin e tij;
- 10) kryen punët e tjera në përputhje me ligjin dhe aktet e Komisionit Zgjedhor të Republikës.

Publikimi dhe dorëzimi i vendimeve të komisionit zgjedhor lokal

Neni 33

Vendimet e komisionit zgjedhor lokal publikohen pa vonesë në ueb-faqe, dhe jo më vonë se 24 orë nga përfundimi i seancës në të cilën janë marrë vendimet, në mënyrën e përcaktuar nga Komisioni Zgjedhor i Republikës.

Komisioni zgjedhor lokal është i detyruar t'i dorëzojë pa vonesë çdo vendim të marrë në lidhje me zbatimin e zgjedhjeve Komisionit Zgjedhor të Republikës në formë të shkruar dhe elektronike në mënyrën e përcaktuar nga Komisioni Zgjedhor i Republikës.

Kur merr dhe publikon vendimin sipas kërkesës, komisioni zgjedhor lokal është i detyruar ta njoftojë me telefon ose e-mail paraqitësin e kërkesës se vendimi sipas kërkesës së tij është marrë dhe publikuar në ueb-faqe.

Nëse vendimi i komisionit zgjedhor lokal është marrë sipas kërkesës, paraqitësi i kërkesës mund të kërkojë që një kopje me shkrim e atij vendimi t'i dorëzohet atij në selinë e komisionit zgjedhor lokal ose t'i dërgohet me postë.

Koha kur është njoftuar me telefon ose e-mail paraqitësi se është marrë dhe publikuar vendimi sipas kërkesës së tij, përkatësisht koha kur i është dorëzuar atij një kopje me shkrim e vendimit në selinë e komisionit zgjedhor lokal ose i është dërguar me postë, nuk ndikon në llogaritjen e afatit brenda të cilit mund paraqesë mjete juridike kundër atij vendimi.

4 Këshilli i vendvotimit

Emërimi dhe kohëzgjatja e funksionit të anëtarit dhe zëvendës anëtarit të këshillit të vendvotimit

Neni 34

Anëtarët dhe zëvendës anëtarët e këshillit të vendvotimit duhet të emërohen jo më vonë se dhjetë ditë para ditës së votimit.

Propozimi për emërimin e anëtarit dhe zëvendës anëtarit të këshillave zgjedhorë mund të paraqitet jo më vonë se 15 ditë para ditës së votimit.

Funksioni i anëtarit dhe zëvendës anëtarit të këshillit të vendvotimit fillon nga dita e publikimit të vendimit për emërimin e tyre, dhe përfundon pas dorëzimit të materialeve zgjedhore pas votimit dhe kontrollimit të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit, si dhe në raste të tjera të parashikuara me ligj.

Këshilli i vendvotimit në përbërje të përhershme

Neni 35

Këshilli i vendvotimit në përbërje të përhershme përbëhet nga një kryetar, dy anëtarë, një zëvendëskryetar dhe dy zëvendës anëtarë të cilët emërohen nga komisioni zgjedhor lokal me propozim të grupeve parlamentare.

Komisioni Zgjedhor i Republikës rregullon më hollësisht procedurën e propozimit të anëtarit dhe zëvendës anëtarit të këshillit të vendvotimit në përbërje të përhershme.

Kur propozon një kandidat për kryetar dhe zëvendëskryetar të këshillit të vendvotimit, grupi parlamentar, nëse është e mundur, i jep përparësi personit që është trajnuar për të punuar në këshillin e vendvotimit dhe i cili ka përvojë në zbatimin e zgjedhjeve.

Kriteret për emërimin e këshillit të vendvotimit në përbërje të përhershme

Neni 36

Numri i kryetarëve, zëvendëskryetarëve, anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve të të gjithë këshillave zgjedhorë në përbërje të përhershme në territorin e komisionit të caktuar zgjedhor lokal i cili i përket grupit parlamentar duhet të jetë në përpjesëtim me përfaqësimin e tij në Ansamblenë Popullore në ditën e hyrjes në fuqi të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve.

Grupi parlamentar i cili në ditën e hyrjes në fuqi të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve ka më shumë se gjysmën e numrit të përgjithshëm të deputetëve popullorë, i propozon në një gjysmë të këshillave zgjedhorë një kryetar dhe dy zëvendës anëtarë, dhe në gjysmën tjetër të këshillave zgjedhorë propozon një zëvendëskryetar, një anëtar dhe një zëvendës të anëtarit tjetër, ndërsa vendet e mbetura në këshillat e vendvotimit u shpërndahen grupeve të tjera parlamentare në përpjesëtim me përfaqësimin e tyre në Ansamblenë Popullore në ditën e hyrjes në fuqi të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve.

Asnjë grup parlamentar nuk mund të propozojë në një vendvotim edhe kryetarin edhe zëvendëskryetarin e këshillit të vendvotimit.

Në bazë të kriterëve të përcaktuara me ligj, Komisioni Zgjedhor i Republikës për territorin e çdo komisioni zgjedhor lokal përcakton dhe publikon në kohë të duhur në ueb-faqe listën e vendeve në bazë të së cilët grupet parlamentare propozojnë anëtarët dhe zëvendës anëtarët e këshillave zgjedhorë në përbërje të përhershme.

Si grup parlamentar në kuptim të propozimit të anëtarit të këshillave zgjedhore në përbërje të përhershme konsiderohet një deputet popullor individual ose një grup deputetësh popullorë i cili është më i vogël se numri i deputetëve të nevojshëm për formimin e grupit parlamentar:

1) nëse të gjithë ata deputetë popullorë janë zgjedhur nga lista e njëjtë zgjedhore;

2) nëse lista zgjedhore në të cilën janë zgjedhur nuk fitoi aq mandate sa është e nevojshme për formimin e grupit parlamentar;

3) nëse askush prej tyre nuk hyri në ndonjë grup parlamentar;

4) nëse të gjithë ata deputetë popullorë kanë nënshkruar propozimin për emërimin e anëtarit, përkatësisht të zëvendës anëtarit të këshillit të vendvotimit në përbërje të përhershme.

Propozimi për emërimin e anëtarit dhe zëvendës anëtarit të këshillit të vendvotimit në përbërje të përhershme

Neni 37

Grupi parlamentar u dorëzon komisioneve zgjedhore lokale propozimin për emërimin e anëtarit dhe zëvendës anëtarit të këshillit të vendvotimit në përbërje të përhershme, në formularin e përcaktuar nga Komisioni Zgjedhor i Republikës.

Nëse grupi parlamentar nuk e dorëzon në kohë të duhur propozimin për emërimin e anëtarit, përkatësisht të zëvendës anëtarit të këshillit të vendvotimit në përbërje të përhershme, komisioni zgjedhor lokal e emëron në këshillin e zgjedhor në përbërje të përhershme personin e propozuar nga kryetari i drejtorisë komunale, përkatësisht të qytetit.

Kur propozon një anëtar, përkatësisht një zëvendës anëtar në këshillin e vendvotimit në përbërje të përhershme, kryetari i drejtorisë komunale, përkatësisht të qytetit, nëse është e mundur, i jep përparësi personit që është trajnuar për të punuar në këshillin e vendvotimit dhe i cili ka përvojë në zbatimin e zgjedhjeve.

këshillat e vendvotimit në përbërje të përhershme jashtë vendit dhe në institucionet për ekzekutimin e sanksioneve penale

Neni 38

Anëtari dhe zëvendës anëtari i këshillit të vendvotimit në përbërje të përhershme jashtë vendit emërohen nga Komisioni Zgjedhor i Republikës me propozim të ministrisë kompetente për punët e jashtme, nëse është e mundur, nga radhët e votuesve me vendbanim jashtë vendit, ndërsa kryetari i këshillit të vendvotimit emërohet nga radha e punonjësve në përfaqësinë diplomatike dhe konsullore të Republikës së Serbisë jashtë vendit (në tekstin e mëtejshëm: përfaqësia diplomatike-konsullore)

Anëtari dhe zëvendës anëtari i këshillit të vendvotimit në përbërje të përhershme në institucionin për ekzekutimin e sanksioneve penale emërohen nga Komisioni Zgjedhor i Republikës me propozim të ministrisë kompetente për drejtësinë, dhe asnjëri prej tyre nuk mund të punojë në atë ministri ose të votojë në institucion.

Këshilli i vendvotimit në përbërje të zgjeruar

Neni 39

Anëtari dhe zëvendës anëtari i këshillit të vendvotimit në përbërje të zgjeruar emërohen nga komisioni zgjedhor lokal me propozim të paraqitësit të listës së shpallur zgjedhore.

Anëtari dhe zëvendës anëtari i këshillit të vendvotimit në përbërje të zgjeruar jashtë vendit dhe në institucionet për ekzekutimin e sanksioneve penale emërohen nga Komisioni Zgjedhor i Republikës me propozim të paraqitësit të listës së shpallur zgjedhore.

Paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore dorëzon propozimin për emërimin e anëtarit dhe zëvendës anëtarit të këshillit të vendvotimit në përbërje të zgjeruar në formularin e përcaktuar nga Komisioni Zgjedhor i Republikës.

Komisioni Zgjedhor i Republikës rregullon më hollësisht procedurën e propozimit të anëtarit dhe zëvendës anëtarit të këshillit të vendvotimit në përbërje të zgjeruar.

Kundërshtimi ndaj vendimit për emërimin e anëtarit dhe zëvendës anëtarit të këshillit të vendvotimit

Neni 40

Kundër vendimit me të cilin është refuzuar propozimi për emërimin e anëtarit, përkatësisht të zëvendës anëtarit të këshillit të vendvotimit, paraqitësi i propozimit mund t'i paraqesë kundërshtim Komisionit Zgjedhor të Republikës brenda 48 orëve nga publikimi i atij vendimi në ueb-faqe.

Paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore, grupi parlamentar dhe votuesi mund t'i paraqesin kundërshtim Komisionit Zgjedhor të Republikës kundër vendimit për emërimin e anëtarit, përkatësisht zëvendës anëtarit të këshillit të vendvotimit në përbërje të përhershme brenda 48 orëve nga publikimi i atij vendimi në ueb-faqe.

Kundër vendimit për emërimin e anëtarit, përkatësisht të zëvendës anëtarit të këshillit të vendvotimit në përbërje të zgjeruar, paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore dhe votuesi mund t'i paraqesin kundërshtim Komisionit Zgjedhor të Republikës brenda 48 orëve nga publikimi i atij vendimi në ueb-faqe.

Ndryshimi i anëtarit të këshillit të vendvotimit

Neni 41

Anëtari, përkatësisht zëvendës anëtari i këshillit të vendvotimit në përbërje të përhershme mund të ndryshohet me kërkesë të propozuesit të autorizuar jo më vonë se tri ditë para ditës së votimit.

Në raste të veçanta, kryetari dhe zëvendëskryetari i këshillit të vendvotimit mund të zëvendësohen jo më vonë se para hapjes së vendvotimit në qoftë se vdesin, sëmuren ose humbasin të drejtën elektorale.

Vendimi për ndryshimin e anëtarit ose zëvendës anëtarit të këshillit të vendvotimit merret nga komisioni që e ka emëruar atë në këshillin e vendvotimit, përkatësisht anëtari i komisionit i autorizuar për këtë nga ana e komisionit.

III. MATERIALI ZGJEDHOR

Rregullat e përgjithshme

Neni 42

Për zbatimin e zgjedhjeve përdoret materiali zgjedhor i hartuar në përputhje me këtë ligj dhe udhëzimin e Komisionit Zgjedhor të Republikës.

Komisioni Zgjedhor i Republikës siguron fletëvotimin, fletën kontrolluese për verifikimin e saktësisë së kutisë së votimit (në tekstin e mëtejshëm: fleta kontrolluese), ekstraktin nga lista e votuesve, listën përmbledhëse zgjedhore të kandidatëve për deputetë popullorë (në tekstin e mëtejshëm: lista përmbledhëse zgjedhore), formularin e procesverbalit për punën e këshillit të vendvotimit, kutinë e votimit, paravanin e votimit për sigurimin e fshehtësinë së votimit (në tekstin e

mëtejshëm: paravani), sprejin për shënimin e gishtit të votuesit, llambën UV dhe materialin tjetër të nevojshëm për zbatimin e votimit.

Komisioni Zgjedhor i Republikës publikon në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë” vendimin për përcaktimin e ngjyrës së fletëvotimit dhe ngjyrës së fletës kontrolluese.

Fletëvotimi dhe fleta kontrolluese nuk mund të jenë me të njëjtën ngjyrë.

Fletëvotimet dhe materiali tjetër zgjedhor printohen në shtypshkronjën e Ndërmarrjes publike “Fletorja Zyrtare” (në tekstin e mëtejshëm: shtypshkronja).

Fletëvotimi

Neni 43

Fletëvotimi përmban:

- 1) emrin e zgjedhjeve dhe datën e votimit;
- 2) numrin rendor që vendoset para emërimit të listës zgjedhore;
- 3) emërtimet e listave zgjedhore sipas rendit të përcaktuar në listën përmbledhëse zgjedhore me emrin dhe mbiemrin e kandidatit të parë nga lista zgjedhore;
- 4) shënimin që mund të votohet për vetëm një listë zgjedhore duke rrumbullakuar numrin rendor para emërimit të kësaj liste;
- 5) shënimin që procesi i votimit është i fshehtë, që bëhet prapa paravanit të votimit, dhe që votuesi, pasi ka plotësuar fletëvotimin, duhet ta palosë në mënyrë që të mos shihet se si është plotësuar dhe kështu të palosur duhet ta hedhë në kutinë e votimit;
- 6) shenjën e vulës së Komisionit Zgjedhor të Republikës

Përdorimi i gjuhëve dhe alfabeteve

Neni 44

Teksti i fletëvotimit printohet në gjuhën serbe, me shkrimin cirilik.

Në komunat, përkatësisht qytetet në të cilat në ditën e shpalljes së zgjedhjeve përdoret zyrtarisht gjuha e pakicës kombëtare, teksti i fletëvotimit printohet në gjuhën serbe, me shkrimin cirilik, dhe nën atë tekst printohet teksti në gjuhën dhe shkrimin e pakicës kombëtare me të njëjtën formë dhe madhësi të shkronjave.

Nëse në një komunë, përkatësisht qytet në ditën e shpalljes së zgjedhjeve përdoren disa gjuhë të pakicave kombëtare, teksti në gjuhët e pakicave kombëtare shkruhet pas tekstit në gjuhën serbe sipas rendit alfabetik të emrit të gjuhës së pakicës kombëtare.

Numri i fletëvotimeve

Neni 45

Numri i fletëvotimeve që printohen duhet të jetë i barabartë me numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listën e votuesve.

Komisioni Zgjedhor i Republikës e përcakton me vendimin e publikuar në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë”, numrin e fletëvotimeve të cilat do të printohen.

Printimi i fletëvotimeve

Neni 46

Fletëvotimet printohen në një letër të mbrojtur me shenjën ujore.

Komisioni Zgjedhor i Republikës përcakton me vendim formën dhe pamjen e fletëvotimit, dhe pjesa përbërëse e këtij vendimi është edhe mostra e fletëvotimit.

Në bazë të mostrës së vulosur të fletëvotimit, shtypshkronja përgatit printimin e fletëvotimeve.

Kopjet e para të fletëvotimeve asgjësohen në vendngjarje gjithnjë derisa të printohet një fletëvotim i cili përmbush standardet e nevojshme grafike.

Fletëvotimi i parë i printuar i cili përmbush standardet e nevojshme grafike krahasohet me mostrën e vulosur të fletëvotimit të kryetarit të Komisionit Zgjedhor të Republikës ose të personit tjetër të autorizuar nga ai.

Pasi ka konstatuar që kopja e printuar e fletëvotimit përputhet me mostrën e vulosur, kryetari i Komisionit Zgjedhor të Republikës ose personi të cilin e autorizoi me nënshkrimin e vet, miraton printimin e fletëvotimeve në një numër të përcaktuar të kopjeve.

Asgjësimi i fletëvotimeve të tepërta dhe i materialeve për përgatitjen e printimit të fletëvotimeve

Neni 47

Menjëherë pas përfundimit të printimit, në prani të së paku tre anëtarëve të autorizuar, përkatësisht të zëvendës anëtarit të Komisionit Zgjedhor të Republikës, të cilët janë emëruar me propozim të propozuesve të ndryshëm të autorizuar asgjësohen të gjitha fletëvotimet e tepërta, si dhe i gjithë materiali i përdorur për përgatitjen e printimit të fletëvotimeve, dhe për këtë përpilohet procesverbali.

Kur të caktohen anëtarët përkatësisht zëvendës anëtarët e Komisionit Zgjedhor të Republikës të cilët marrin pjesë në asgjësimin e fletëvotimeve të tepërta dhe të materialeve të përdorura për përgatitjen e printimit të fletëvotimeve, të paktën një anëtar, përkatësisht zëvendës anëtar i Komisionit Zgjedhor të Republikës duhet të jetë përfaqësues i listës zgjedhore opozitare (lista zgjedhore paraqitësi i së cilës nuk është një parti parlamentare, përkatësisht lista zgjedhore paraqitësi i së cilës nuk është pjesë e mazhorancës parlamentare në ditën e hyrjes në fuqi të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve).

Mbikëqyrja e printimit dhe dorëzimit të fletëvotimeve

Neni 48

Komisioni Zgjedhor i Republikës kontrollon printimin e fletëvotimeve.

Përfaqësuesit e paraqitësve të listave zgjedhore dhe përfaqësuesit e vëzhguesve vendas dhe të huaj kanë të drejtë të marrin pjesë në printimin, numërimin dhe paketimin e fletëvotimeve dhe dorëzimin e tyre në Komisionin Zgjedhor të Republikës, komisionet zgjedhore lokale dhe këshillat e vendvotimit para dhe pas votimit.

Komisioni Zgjedhor i Republikës është i detyruar të informojë në kohë paraqitësit e listave zgjedhore dhe vëzhguesit vendas dhe të huaj se ku dhe kur fillon printimi i fletëvotimeve, ku dhe kur u dorëzohen fletëvotimet komisioneve zgjedhore lokale, si dhe ku dhe kur u dorëzohen fletëvotimet këshillave zgjedhorë.

Mohimi i të drejtave për mbikëqyrjen e printimit dhe dorëzimin e fletëvotimeve

Neni 49

Përfaqësuesi i Komisionit Zgjedhor të Republikës i autorizuar për kontrollin e printimit të fletëvotimeve mund t'ia mohojë përfaqësuesit të listës së shpallur zgjedhore dhe përfaqësuesit të vëzhguesit vendas ose të huaj të drejtën për mbikëqyrjen e printimit të fletëvotimeve nëse ai pengon printimin dhe paketimin e fletëvotimeve ose nëse nuk respekton masat e parashikuara të mbrojtjes në shtypshkronjë, dhe për këtë përpilohet një shënim zyrtar që i dorëzohet menjëherë Komisionit Zgjedhor të Republikës.

Përfaqësuesit e Komisionit Zgjedhor të Republikës, komisionit zgjedhor lokal dhe këshillit të vendvotimit, të cilët janë të autorizuar të kryejnë punët e dorëzimit të fletëvotimeve para dhe pas votimit, mund t'ia mohojnë përfaqësuesit të listës së shpallur zgjedhore dhe përfaqësuesit të vëzhguesit vendas ose të huaj të drejtën të vëzhgojë dorëzimin e fletëvotimeve nëse pengon dorëzimin e fletëvotimeve, dhe për këtë përpilohet një shënim zyrtar që i dorëzohet menjëherë Komisionit Zgjedhor të Republikës.

Ndaj vendimit që t'i mohohet përfaqësuesit të listës së shpallur zgjedhore dhe përfaqësuesit të vëzhguesit e drejta për mbikëqyrjen e printimit të fletëvotimeve, përkatësisht e drejta për vëzhgimin e dorëzimit të fletëvotimeve, vëzhguesi, përkatësisht paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore përfaqësuesit të së cilës i është mohuar e drejta për mbikëqyrje ose vëzhgim, mund t'i paraqesë kundërshtim Komisionit Zgjedhor të Republikës brenda 48 orëve nga momenti kur i është mohuar përfaqësuesit e drejta për mbikëqyrje, përkatësisht vëzhgim.

Kutia e votimit

Neni 50

Për votim në zgjedhjet përdoret kutia e tejdukshme e votimit me mbulesën lëvizëse e cila ka një vrimë për hedhjen e fletëvotimeve.

Komisioni Zgjedhor i Republikës përcakton më hollësisht formën dhe përmasat e kutisë së votimit.

Spreji për shënimin e gishtit të votuesit

Neni 51

Si shenjë që votuesi votoi shënohet gishti i votuesit me sprejin prej ngjyre të patretshme UV, i cili shihet nën dritën e llambës UV.

Paravani

Neni 52

Komisioni Zgjedhor i Republikës përcakton formën dhe dimensionet e paravanit dhe mënyrën e vendosjes së tyre në një vendvotim.

Ruajtja e materialit zgjedhor pas përfundimit të zgjedhjeve

Neni 53

Fletëvotimet, fletët kontrolluese dhe ekstraktet nga lista e votuesve ruhen për një vit nga data e publikimit të raportit të përgjithshëm të rezultateve të zgjedhjeve.

Materiali dhe dokumentacioni tjetër zgjedhor në lidhje me zbatimin e zgjedhjeve ruhen në përputhje me dispozitat të cilat rregullojnë ruajtjen e lëndës arkivore dhe të materialit dokumentar.

E drejta e qasjes në materialin zgjedhor pas përfundimit të votimit

Neni 54

Përfaqësuesi i paraqitësit të listës së shpallur zgjedhore dhe kandidati për deputet popullor kanë të drejtë ta inspektojnë brenda 5 ditëve nga dita e votimit materialin zgjedhor në ambientet zyrtare të komisionit zgjedhor lokal, përfshirë ekstraktet nga lista e votuesve, procesverbalet e punës së këshillave zgjedhorë dhe fletëvotimet.

Qasja në materialin zgjedhor nga vendvotimet jashtë vendit bëhet në ambientet zyrtare të Komisionit Zgjedhor të Republikës.

Gjatë qasjes në materialin zgjedhor, ndalohet xhirimi, fotografimi dhe regjistrimi i të dhënave të votuesve nga ekstraktet nga lista e votuesve, si dhe kopjimi i ekstrakteve nga lista e votuesve.

Komisioni Zgjedhor i Republikës përcakton më hollësisht mënyrën e realizimit të së drejtës së qasjes në materialin zgjedhor.

Rregullat që i referohen realizimit të së drejtës së qasjes së përfaqësuesit të paraqitësit të listës së shpallur zgjedhore dhe kandidatit për deputet popullorë zbatohen edhe mbi kërkesat për qasje në materialin zgjedhor bazuar në ligje të tjera, si dhe mbi kërkesat për qasje në materialin zgjedhor në përputhje me dispozitat e këtij ligji të cilat rregullojnë kontrollin e procesverbalit për punën e këshillit të vendvotimit që kryhet nga anëtarët e Komisionit Zgjedhor të Republikës dhe të komisionit zgjedhor lokal dhe kontrollin e procesverbalit për punën e këshillit të vendvotimit sipas mostrës.

Informacionet rreth evidentimit në ekstraktin nga lista e votuesve

Neni 55

Votuesi ka të drejtë që t'i kërkojë komisionit zgjedhor lokal informacionin nëse është evidentuar në ekstraktin nga lista e votuesve që ai votoi në zgjedhjet.

Komisioni Zgjedhor i Republikës është kompetent për dhënien e informacioneve nëse është evidentuar në ekstraktin nga lista e votuesve se votuesi ka votuar në një vendvotim jashtë vendit.

Komisioni Zgjedhor i Republikës përcakton mënyrën e realizimit të së drejtës për informacion nëse është evidentuar se ndonjë votues ka votuar.

IV. VENDVOTIMET

Kompetenca për përcaktimin e vendvotimeve

Neni 56

Komisioni zgjedhor lokal cakton vendvotimet në bazë të propozimeve të administratave komunale, përkatësisht të qyteteve jo më vonë se dhjetë ditë nga dita e hyrjes në fuqi të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve.

Komisioni Zgjedhor i Republikës cakton vendvotimet në institucionet për ekzekutimin e sanksioneve penale me propozim të ministrisë kompetente për drejtësinë dhe vendvotimet jashtë vendit me propozim të ministrisë kompetente për punët e jashtme jo më vonë se 20 ditë para ditës së votimit.

Vendvotimet në të cilat mund të votojnë personat që në ditën e votimit janë duke kryer shërbimin ushtarak, janë në stërvitje ushtarake ose shkollim në njësitë ose institucionet e Ushtrisë së Serbisë caktohen nga Komisioni Zgjedhor i Republikës me propozim të ministrisë kompetente për mbajtjen e listës së votuesve,

të cilën e harton në bazë të të dhënave të dorëzuara nga Ministria e Mbrojtjes duke bashkëpunuar me administratat komunale, përkatësisht të qytetit.

Mënyra e caktimit të vendvotimeve

Neni 57

Vendvotimi është caktuar në mënyrë që të jetë i arritshëm për votuesit dhe që t'u mundësojë atyre të votojnë pa vështirësi.

Një vendvotim, nëse është e mundur, caktohet për votim të jo më shumë se 2500 votuesve, dhe jo më pak se 100.

Në raste të jashtëzakonshme, me pëlqimin e Komisionit Zgjedhor të Republikës, vendvotimi mund të caktohet edhe për më shumë se 2.500 votues nëse nuk ka kushte për hapjen e më shumë vendvotimeve, përkatësisht për më pak se 100 votues nëse banorët e një vendi të caktuar do të kishin vështirësi të mëdha për të votuar në një vendvotim tjetër për shkak të distancës hapësinore ose pozitës së pavolitshme gjeografike.

Për çdo vendvotim caktohet numri i vendvotimit, emërtimi i vendvotimit, adresa e vendvotimit dhe zona nga e cila votojnë votuesit në atë vendvotim (rrugë, fshat, katund, vendbanim etj.).

Mënyra e caktimit të vendvotimeve përcaktohet më hollësisht nga Komisioni Zgjedhor i Republikës.

Ambientet e votimit

Neni 58

Si vendvotime caktohen ambientet në objektet publike, dhe vetëm në raste të jashtëzakonshme edhe ambientet në objektet private.

Si një vendvotim nuk mund të caktohet ambienti në objektin fetar, objektin në pronësi të një partie politike ose objektin që përdoret nga një parti politike, as në një objekt në pronësi të një kandidati për deputet popullor ose objektin e një anëtarit të familjes së tij.

Të gjitha objektet në të cilat gjenden ambientet e përcaktuara si vendvotime, pa marrë parasysh nëse janë në pronësi publike ose private, konsiderohen gjatë votimit si objekte në përdorim publik në kuptim të ligjit që rregullon lëvizjen me ndihmën e qenit udhërrëfyes.

V. ECURIA E PROCEDURËS ZGJEDHORE

1 Shpallja e zgjedhjeve

Kompetenca për shpalljen e zgjedhjeve

Neni 59

Zgjedhjet shpallen nga presidenti i Republikës.

Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve hyn në fuqi në ditën e publikimit në "Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë".

Afatet për shpalljen e zgjedhjeve dhe votimin

Neni 60

Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve merret 90 ditë para se të skadojnë katër vjet nga dita e konstituimit të Ansamblesë Popullore.

Nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e votimit nuk mund të kalojnë më pak se 45 as më shumë se 60 ditë.

Përmbajtja e vendimit për shpalljen e zgjedhjeve

Neni 61

Dita e votimit caktohet me vendimin për shpalljen e zgjedhjeve.

Si ditë e votimit caktohet një ditë jo pune.

2 Paraqitja e listës zgjedhore

Paraqitësi i listës zgjedhore

Neni 62

Lista zgjedhore mund të paraqitet nga partia politike e regjistruar në Regjistrin e partive politike (në tekstin e mëtejshëm: partia politike), koalicioni i partive politike dhe grup qytetarësh.

Lista zgjedhore nuk mund të paraqitet nga koalicioni i përbërë nga një parti politike dhe një grup qytetarësh.

Partia politike si paraqitës i listës zgjedhore

Neni 63

Lista zgjedhore paraqitet në emër të partisë politike nga përfaqësuesi i regjistruar në Regjistrin e partive politike ose personi i autorizuar nga ai.

Autorizimi për paraqitjen e listës zgjedhore jepet me shkrim, dhe nënshkrimi në autorizimin nuk duhet të vulozet.

Koalicioni i partive politike si paraqitës i listës zgjedhore

Neni 64

Koalicioni i partive politike (në tekstin e mëtejshëm: koalicioni) formohet nga të paktën dy parti politike me një marrëveshje (në tekstin e mëtejshëm: marrëveshje koalicioni) e cila lidhet në formë të dokumentit publikisht të vulosur (të legalizuar).

Marrëveshja e koalicionit përmban detyrimisht:

- 1) emrin e koalicionit;
- 2) pretendimin se koalicioni formohet me qëllim të paraqitjes së listës zgjedhore për pjesëmarrje në zgjedhjet për deputetë popullorë;
- 3) emrin e listës zgjedhore;
- 4) të dhënat për jo më shumë se dy persona të autorizuar për paraqitjen e listës zgjedhore (emrin dhe mbiemrin, JMBG-në, vendin dhe adresën e vendbanimit, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike);
- 5) shenjën e partisë politike dhe të dhënat e personit përgjegjës për menaxhimin financiar, paraqitjen e raporteve, respektimin e detyrimeve, ndalimeve dhe kufizimeve të parashikuara me ligjin i cili rregullon financimin e aktiviteteve politike, për mbajtjen e evidencave dhe kontaktin me Agjencinë për parandalimin e korrupsionit (emrin dhe mbiemrin, JMBG-në, vendin dhe adresën e vendbanimit, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike);
- 6) datën e lidhjes së marrëveshjes së koalicionit.

Marrëveshja e koalicionit duhet të lidhet dhe të vulozet pas hyrjes në fuqi të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve, dhe para fillimit të mbledhjes së nënshkrimeve të votuesve për mbështetjen e tyre në listën zgjedhore.

Grup qytetarësh si paraqitës i listës zgjedhore

Neni 65

Grup qytetarësh formohet prej të paktën dhjetë votuesve me marrëveshjen e lidhur në formë të dokumentit publikisht të vulosur (të legalizuar).

Marrëveshja e formimit të grupit të qytetarëve duhet të përmbajë:

- 1) emrin e grupit të qytetarëve;
- 2) pretendimin se grup qytetarësh formohet me qëllim të paraqitjes së listës zgjedhore për pjesëmarrje në zgjedhjet për deputetë popullorë;
- 3) emrin, mbiemrin, JMBG-në, vendin dhe adresën e vendbanimit të votuesve të cilët formojnë grupin e qytetarëve;
- 4) emrin e listës zgjedhore;
- 5) të dhënat për jo më shumë se dy persona të autorizuar për paraqitjen e listës zgjedhore (emrin dhe mbiemrin, JMBG-në, vendin dhe adresën e vendbanimit, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike);
- 6) të dhënat e personit përgjegjës për menaxhimin financiar, paraqitjen e raporteve, respektimin e detyrimeve, ndalimeve dhe kufizimeve të parashikuara me ligjin i cili rregullon financimin e aktiviteteve politike, për mbajtjen e evidencave dhe kontaktin me Agjencinë për parandalimin e korrupsionit (emrin dhe mbiemrin, JMBG-në, vendin dhe adresën e vendbanimit, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike);
- 7) datën e lidhjes së marrëveshjes për formimin e grupit të qytetarëve.

Marrëveshja për formimin e grupit të qytetarëve duhet të lidhet dhe të vuloset pas hyrjes në fuqi të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve, dhe para fillimit të mbledhjes së nënshkrimeve të votuesve për mbështetjen e tyre në listën zgjedhore.

Pozita e personit të autorizuar për paraqitjen e listës zgjedhore

Neni 66

Paraqitësi i listës zgjedhore mund t'i autorizojë për paraqitjen e listës zgjedhore jo më shumë se dy persona.

Nëse nuk është përcaktuar ndryshe me aktin me të cilin autorizohen dy persona për paraqitjen e listës zgjedhore, secili prej tyre mund të ndër marrë në mënyrë të pavarur veprimet për të cilat është autorizuar.

Personi i autorizuar për paraqitjen e listës zgjedhore mund të kryejë në emër të paraqitësit të listës zgjedhore edhe veprime të tjera në procedurën zgjedhore, në qoftë se paraqitësi i listës zgjedhore nuk ka përcaktuar ndryshe me aktin me të cilin i jep atij këtë autorizim.

Revokimi dhe ngushtimi i kompetencës për paraqitjen e listës zgjedhore dhe ndërmarrjen e veprimeve të tjera në procedurën zgjedhore fillon të prodhojë efekt juridik kur Komisioni Zgjedhor i Republikës merr për këtë njoftimin me shkrim.

Personi i autorizuar për paraqitjen e listës zgjedhore mund t'i kalojë personit tjetër autorizimin e vet nëse paraqitësi i listës zgjedhore nuk ka përcaktuar ndryshe me aktin për dhënien e autorizimit.

Emri i paraqitësit të listës zgjedhore

Neni 67

Partia politike në listën zgjedhore e shënon si emër të paraqitësit të listës emërtimin e saj të plotë dhe/ose të shkurtuar nën të cilin është regjistruar në Regjistrin e partive politike.

Koalicioni në listën zgjedhore e shënon si emër të paraqitësit të listës zgjedhore emërtimin e përcaktuar me marrëveshjen e koalicionit i cili duhet të fillojë me fjalën: Koalicioni.

Grup qytetarësh në listën zgjedhore e shënon si emër të paraqitësit të listës zgjedhore emrin e përcaktuar me marrëveshjen e formimit të grupit të qytetarëve i cili duhet të fillojë me fjalët: Grup qytetarësh.

Emërtimi i grupit të qytetarëve nuk mund të përmbajë fjalën “parti” në asnjë rast.

Emërtimi i koalicionit ose grupit të qytetarëve mund të përmbajë emrin dhe mbiemrin e një personi fizik ose emrin e një personi juridik nëse ai pajtohet me këtë me shkrim, me ç’rast konsiderohet se personi fizik duke nënshkruar listën zgjedhore, marrëveshjen e koalicionit, marrëveshjen për formimin e grupit të qytetarëve apo autorizimin për lidhjen e këtyre marrëveshjeve ishte dakord edhe me faktin që emri i tij të përdoret në emrin e paraqitësit të listës zgjedhore.

Emërtimi i listës zgjedhore

Neni 68

Partia politike në listën zgjedhore e shënon emrin e listës së saj, ndërsa koalicioni dhe grupi i qytetarëve në listën zgjedhore shënojnë emrin e listës i cili është përcaktuar me marrëveshjen e koalicionit, përkatësisht me marrëveshjen për formimin e grupit të qytetarëve.

Emërtimi i listës zgjedhore mund të përmbajë edhe emrin e personit juridik nëse personi juridik pajtohet me këtë me shkrim.

Emërtimi i listës zgjedhore të paraqitur nga grupi i qytetarëve nuk mund të përmbajë fjalën “parti” në asnjë rast.

Bartësi i listës

Neni 69

Emërtimi i listës zgjedhore mund të përmbajë emrin dhe mbiemrin e një ose më shumë personave fizikë (bartës i listës) nëse ata pajtohen me këtë me shkrim, me ç’rast supozohet se personi ra dakord, duke nënshkruar listën zgjedhore, autorizimin për paraqitjen e listës zgjedhore, marrëveshjen e koalicionit, marrëveshjen për formimin e grupit të qytetarëve ose autorizimin për lidhjen e këtyre marrëveshjeve, që emri i tij të përdoret në emrin e listës zgjedhore.

Emërtimi i listës zgjedhore mund ta përmbajë së bashku me emrin e bartësit të listës edhe nofkën e tij ose pseudonimin e tij të njohur.

Emërtimi i listës zgjedhore nuk mund të përmbajë emrat e figurave historike apo imagjinare.

Bartësi i listës mundet, por nuk duhet të jetë kandidat për deputet në atë listë zgjedhore.

Bartës i listës mund të jetë edhe personi që është kandidat për organ tjetër shtetëror, përkatësisht kandidat ose bartës i listës për zgjedhjen e organit të krahinës

autonome ose të njësisë së vetëqeverisjes lokale për të cilën zbatohen zgjedhjet njëkohësisht.

I njëjti person nuk mund të jetë bartës i dy listave zgjedhore, as nuk mund të jetë bartës i një liste zgjedhore, dhe kandidat për deputet popullor në listën tjetër zgjedhore.

Afati për paraqitjen e listës zgjedhore dhe përmbajtja e saj

Neni 70

Lista zgjedhore i paraqitet drejtpërdrejt Komisionit Zgjedhor të Republikës në formë të shkruar dhe elektronike në formularin e përcaktuar, jo më vonë se 20 ditë para ditës së votimit.

Lista zgjedhore përmban emrin e paraqitësit të listës zgjedhore, emrin e listës zgjedhore, numrin rendor të kandidatit për deputet popullor, si edhe emrin, mbiemrin, JMBG-në, profesionin, vendin dhe adresën e vendbanimit për secilin kandidat për deputet popullor, emrin, mbiemrin, JMBG-në, vendin dhe adresën e vendbanimit, numrin e telefonit, adresën e postës elektronike dhe nënshkrimin e personit i cili paraqet listën zgjedhore.

Nëse lista zgjedhore paraqitet nga koalicioni, për secilin kandidat për deputet popullor në listën zgjedhore shënohet emërtimi i plotë ose i shkurtuar i partisë politike e cila e kandidoi atë.

Pas shpalljes së listës zgjedhore, paraqitësit i listës zgjedhore nuk mund të ndryshojë rendin e kandidatëve në listën zgjedhore.

Dokumentacioni që dorëzohet me listën zgjedhore

Neni 71

Gjatë paraqitjes së listës zgjedhore i dorëzohet detyrimisht Komisionit Zgjedhor të Republikës edhe dokumentacioni i mëposhtëm:

1) pëlqimi me shkrim të secilit kandidati se pranon kandidaturën për deputet popullor në formularin e përcaktuar nga Komisioni Zgjedhor i Republikës, i cili përmban emrin dhe mbiemrin e tij, JMBG-në, profesionin, vendin dhe adresën e vendbanimit;

2) dokumenti për letërnjoftimin e lexuar me mikrokontrolluesin (çipin), përkatësisht fotokopja e letërnjoftimit pa mikrokontrollues për secilin kandidat për deputet popullor;

3) të paktën 10.000 deklaratat me shkrim të votuesve se mbështesin listën zgjedhore në formularin e përcaktuar nga Komisioni Zgjedhor i Republikës, të cilat janë vulosur para skadimit të afatit për paraqitjen e listës zgjedhore dhe të cilat përmbajnë emrin, mbiemrin, JMBG-në, vendin dhe adresën e vendbanimit për secilin votues;

4) lista e votuesve të cilët nënshkruan deklaratat e paraqitura se mbështesin listën zgjedhore në formë elektronike në formularin e përcaktuar nga Komisioni Zgjedhor i Republikës, dhe e cila përmban emrin dhe mbiemrin e votuesit, JMBG-në e tij dhe të dhënat rreth personit që vulosi nënshkrimin e deklaratës;

5) pëlqimi me shkrim i bartësit të listës që të përdoret emri i tij personal në emërtimin e listës zgjedhore, e cila përmban emrin dhe mbiemrin e tij, JMBG-në, vendin dhe adresën e vendbanimit nëse lista zgjedhore e përmban në emërtimin e vet emrin e tij personal dhe nëse ai nuk nënshkroi ndonjë dokument tjetër që paraqitet me listën zgjedhore, dhe nënshkrimi i së cilës konsiderohet si dhënie e pëlqimit që emri i tij personal të përdoret në emrin e listës zgjedhore;

6) pëlqimi me shkrim i personit juridik që të përdoret emri i tij në emrin e listës zgjedhore, e cila përmban emrin dhe selinë e personit juridik i cili jep këtë pëlqim;

7) autorizimi që të paraqitet në emër të partisë politike lista zgjedhore nëse nuk e paraqet përfaqësuesi i regjistruar në Regjistrin e partive politike, dhe i cili jepet me shkrim dhe përmban emrin, mbiemrin, JMBG-në, vendin dhe adresën e vendbanimit të personit të autorizuar;

8) marrëveshja e koalicionit nëse lista zgjedhore paraqitet nga koalicioni;

9) autorizimi që të lidhet në emër të partisë politike marrëveshja e koalicionit, nëse nuk është lidhur nga përfaqësuesi i regjistruar në Regjistrin e partive politike, dhe i cili jepet me shkrim dhe përmban emrin, mbiemrin, JMBG-në, vendin dhe adresën e vendbanimit të personit të autorizuar;

10) marrëveshja për formimin e grupit të qytetarëve nëse lista zgjedhore paraqitet nga grupi i qytetarëve;

11) pëlqimi me shkrim që, në emrin e koalicionit, përkatësisht të grupit të qytetarëve, të përdoret emri personal i personit fizik ose emri i personit juridik, dhe i cili përmban emrin, mbiemrin, JMBG-në, vendin dhe adresën e vendbanimit të personit fizik, përkatësisht emrin dhe selinë e personit juridik i cili jep këtë pëlqim nëse koalicioni, përkatësisht grup qytetarësh përmban në emërtimin e vet emrin personal të atij personi fizik, përkatësisht emrin e atij personi juridik dhe nëse ai person fizik nuk nënshkroi një dokument tjetër që paraqitet me listën zgjedhore, nënshkrimi i së cilës konsiderohet si dhënie pëlqimi që të përdoret emri i tij personal në emrin e koalicionit, përkatësisht të grupit të qytetarëve.

Mbledhja e nënshkrimeve të votuesve të cilët mbështesin listën zgjedhore

Neni 72

Votuesi mund ta mbështet me nënshkrim vetëm një listë zgjedhore.

Deklarata e votuesit se mbështet listën zgjedhore vulozet te noteri publik ose tek administrata komunale, përkatësisht e qytetit, dhe në komunat, përkatësisht qytetet ku nuk janë emëruar noterët publikë, deklarata e votuesit se mbështet listën zgjedhore mund të vulozet edhe nga gjykata themelore, njësia gjyqësore ose zyra e pranimit në gjykatën themelore.

Shuma e tarifës për vulosjen e nënshkrimit të votuesit që mbështet listën zgjedhore përcaktohet nga ministra kompetente.

Deklarata e vulosur e votuesit se mbështet listën zgjedhore është e plotfuqishme edhe kur janë bërë gabime gjatë plotësimit të formularit nëse mund të konstatohet me siguri se cila listë zgjedhore është mbështetur dhe se deklarata është vulosur nga organi kompetent.

Ndalohet mbledhja e nënshkrimeve të mbështetjes nga votuesit në vendin e tyre të punës ose të bëhet çfarëdo lloj presioni ndaj votuesit për të mbështetur me nënshkrimin e tij ndonjë listë zgjedhore.

Komisioni Zgjedhor i Republikës e publikon në ueb-faqe, jo më vonë se shtatë ditë para ditës së votimit, për secilën listë të shpallur zgjedhore, numrin e deklaratave të vulosura të votuesve që kanë mbështetur me nënshkrimet e tyre atë listë zgjedhore sipas njësive të vetëqeverisjes lokale, me të dhënat rreth numrit të deklaratave të vulosura në kuadër të çdo njësie të vetëqeverisjes lokale nga secili prej noterëve të autorizuar (noteri publik, administrata komunale, përkatësisht e qytetit ose gjykata themelore, njësia gjyqësore ose zyra e pranimit në gjykatën themelore).

Përfaqësimi gjinor në listën zgjedhore

Neni 73

Të paktën 40% e pjesëtarëve të gjinisë më pak të përfaqësuar duhet të jenë në listën zgjedhore, kështu që në çdo pesë kandidatë sipas rendit në listë (pesë vende të para, pesë vende të dyta dhe kështu me radhë deri në fund) duhet të ketë tre pjesëtarë të njëjës gjinie dhe dy pjesëtarë të gjinisë tjetër.

Afati i vendimmarrjes për listën zgjedhore

Neni 74

Komisioni Zgjedhor i Republikës është i detyruar të marrë vendim për listën zgjedhore brenda 48 orëve nga paraqitja e saj.

Shpallja e listës zgjedhore

Neni 75

Komisioni Zgjedhor i Republikës shpall me vendim në kohën e duhur listën zgjedhore të rregullt, së cilës i bashkëngjitet i gjithë dokumentacioni i përcaktuar me ligj dhe i cili përmbush të gjitha kushtet e përcaktuara me ligj për shpallje.

Listat zgjedhore shpallen sipas rendit të përmbushjes së kushteve për shpallje.

Refuzimi i listës zgjedhore

Neni 76

Komisioni Zgjedhor i Republikës hedh poshtë me vendim listën zgjedhore që nuk është paraqitur në kohë të duhur, listën zgjedhore të parregullt dhe listën zgjedhore të paraqitur nga një person i paautorizuar për të propozuar kandidatët për deputetë popullorë.

Lista zgjedhore e parregullt është lista e kandidatëve për deputetë popullorë e cila nuk është paraqitur në formularin e parashikuar ose që nuk përmban emrin e listës zgjedhore ose emrin e paraqitësit të listës zgjedhore ose të dhënat e parashikuara të kandidatëve për deputetë popullorë.

Refuzimi i shpalljes së listës zgjedhore

Neni 77

Komisioni Zgjedhor i Republikës refuzon me vendim shpalljen e listës zgjedhore nëse është propozuar për deputet popullor një person i cili nuk ka të drejtën elektorale, i cili është kandidat për deputet popullor në listën zgjedhore të shpallur më parë ose është bartës i listës zgjedhore të shpallur më parë, nëse nuk janë respektuar rregullat ligjore për përfaqësimin e gjinive në listën zgjedhore dhe nëse emri i paraqitësit të listës zgjedhore dhe emërtimi i listës zgjedhor nuk janë përcaktuar në përputhje me ligj.

Heqja e mangësive

Neni 78

Nëse paraqitësi i listës zgjedhore nuk ka bashkëngjitur të gjithë dokumentacionin e paraqitur me listën zgjedhore dhe nëse ka mangësi të tjera për shpalljen e listës zgjedhore të cilat nuk përbëjnë bazë për refuzimin ose mospranimin e listës zgjedhore, Komisioni Zgjedhor i Republikës do të nxjerrë konkluzion që urdhëron paraqitësin që t'i eliminojë ato mangësi brenda 48 orëve nga publikimi i atij konkluzioni në ueb-faqe dhe i tregon atij se çfarë dokumentacioni duhet të paraqesë, përkatësisht çfarë duhet të bëjë për të eliminuar ato mangësi dhe e paralajmëron atë për pasojat juridike nëse nuk i eliminon brenda afatit ato mangësi.

Nëse paraqitësi i listës zgjedhore nuk paraqet dokumentacionin, përkatësisht nëse nuk heq mangësitë e konstatuara me konkluzionin, brenda 24 orëve nga skadimi i afatit për të vepruar sipas konkluzionit Komisioni Zgjedhor i Republikës merr vendim me të cilin refuzon të shpallë atë listë zgjedhore.

Nëse paraqitësi i listës zgjedhore heq të gjitha mangësitë që i ka treguar në konkluzion, Komisioni Zgjedhor i Republikës duhet të marrë vendimin me të cilin shpallet kjo listë zgjedhore brenda 24 orëve nga heqja e mangësive.

Kundërshtimet ndaj vendimeve për listën zgjedhore

Neni 79

Kundër vendimit për refuzimin e shpalljes së listës zgjedhore dhe vendimit për refuzimin e listës zgjedhore, paraqitësi i listës zgjedhore mund t'i paraqesë kundërshtim Komisionit Zgjedhor të Republikës brenda 48 orëve nga publikimi i atij vendimi në ueb-faqe.

Kundër vendimit për shpalljen e listës zgjedhore, kandidati për deputet popullor në atë listë zgjedhore, personi emri i të cilit është përbërë në emrin e asaj liste zgjedhore, përkatësisht në emrin e paraqitësit të asaj liste zgjedhore, partia politike, paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore dhe votuesi mund t'i paraqesin kundërshtim Komisionit Zgjedhor të Republikës brenda 48 orëve nga publikimi i atij vendimi në ueb-faqe.

Nuk lejohet kundërshtim ndaj konkluzionit me të cilin i urdhërohet paraqitësit që të eliminojë mangësitë e listës zgjedhore, por ai konkluzion mund të rrëzohet me kundërshtim ndaj vendimit me të cilin është marrë vendimi për listën zgjedhore.

E drejta e qasjes

Neni 80

Paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore ka të drejtë që ta kryejë, brenda 48 orëve nga dita e shpalljes së listës përmbledhëse zgjedhore, përmes personit të autorizuar, qasjen në të gjitha listat e paraqitura zgjedhore dhe dokumentacionin e paraqitur me to.

Kur të bëhet qasje në listat e shpallura zgjedhore dhe dokumentacionin e paraqitur me to, ndalohet xhirimi, fotografimi dhe regjistrimi i të dhënave personale.

Rregullat që kanë të bëjnë me realizimin e së drejtës së qasjes së përfaqësuesit të paraqitësit të listës së shpallur zgjedhore zbatohen edhe mbi kërkesat e qasjes në listat e shpallura zgjedhore dhe mbi dokumentacionin e paraqitur me to në bazë të ligjeve të tjera.

Tërheqja e listës së shpallur zgjedhore

Neni 81

Paraqitësi mund të tërheqë listën e shpallur zgjedhore jo më vonë se para ditës së përcaktimit të listës përmbledhëse zgjedhore.

Lista e shpallur zgjedhore e paraqitur nga koalicioni mund të tërhiqet nëse me këtë pajtohen të gjitha partitë që kanë lidhur marrëveshjen e koalicionit, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me marrëveshjen e koalicionit.

Lista e shpallur zgjedhore e paraqitur nga një grup qytetarësh mund të tërhiqet nëse me këtë pajtohen të gjithë votuesit të cilët kanë formuar grupin e qytetarëve, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me marrëveshjen për formimin e grupit të qytetarëve.

Komisioni Zgjedhor i Republikës konstaton me vendim jo më vonë se para ditës së përcaktimit të listës përmbledhëse zgjedhore se është tërhequr lista e shpallur zgjedhore.

Përjashtimi i kandidatit nga lista e shpallur zgjedhore

Neni 82

Kandidati për deputet popullor nuk mund të heqë dorë nga kandidatura e tij pasi është marrë vendimi për shpalljen e listës zgjedhore.

Nëse kandidati për deputet popullor vdes ose humb të drejtën elektorale pas marrjes së vendimit për shpalljen e listës zgjedhore, paraqitësi i listës zgjedhore nuk mund të propozojë një kandidat të ri, dhe Komisioni Zgjedhor i Republikës konstaton me vendim jo më vonë se para ditës së përcaktimit të listës përmbledhëse zgjedhore që mbetet i zbrazët vendi i atij kandidati në listën zgjedhore.

Lista e shpallur zgjedhore nuk mund të kontestohet nëse është shkëlur për shkak të vdekjes ose humbjes së së drejtës elektorale rregulli i përcaktuar me ligj mbi përfaqësimin gjinor në listën zgjedhore.

Lista përmbledhëse zgjedhore

Neni 83

Komisioni Zgjedhor i Republikës merr vendimin me të cilin konfirmon listën përmbledhëse zgjedhore dhe e publikon atë në Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë” jo më vonë se 15 ditë para ditës së votimit.

Lista përmbledhëse zgjedhore përmban të gjitha listat zgjedhore me emrat personal të kandidatëve për deputetët popullorë dhe të dhënat e tyre të vitit të lindjes, profesionit dhe vendbanimit.

Renditja e listave zgjedhore në listën përmbledhëse zgjedhore përcaktohet sipas renditjes së shpalljes.

Në komunën ose qytetin ku gjuha e pakicës kombëtare është në përdorimin zyrtar në ditën e shpalljes së zgjedhjeve, përveç listës përmbledhëse zgjedhore e cila do të printohet në gjuhën serbe dhe në alfabetin cirilik, do të hartohet edhe lista përmbledhëse zgjedhore në gjuhën dhe alfabetin e pakicës kombëtare në të njëjtën formë dhe madhësi të shkronjave.

Lista përmbledhëse zgjedhore duhet të shpallet qartë në vendvotim gjatë votimit.

Kundërshtim ndaj Listës përmbledhëse zgjedhore

Neni 84

Paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore mund të t'i paraqesë kundërshtim Komisionit Zgjedhor të Republikës kundër vendimit për konfirmimin e listës përmbledhëse zgjedhore, brenda 48 orëve nga shpallja e këtij vendimi në ueb-faqe.

Kundërshtimi ndaj vendimit për përcaktimin e listës përmbledhëse zgjedhore nuk mund të kontestojë vlefshmërinë e plotë të listës përmbledhëse zgjedhore.

3 Votimi në vendvotim

Vendvotimi i votuesit

Neni 85

Votuesi voton në vendvotimin në të cilin është regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve.

Përgjithësisht, votuesi mund të votojë edhe jashtë vendvotimit në të cilin është regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve në përputhje me ligjin.

Ftesa për votim

Neni 86

Administrata e komunës ose të qytetit, jo më vonë se pesë ditë para ditës së votimit, ia dorëzon votuesit ftesën e votimit e cila përmban: datën dhe orën e votimit, numrin dhe adresën e vendvotimit dhe numrin me të cilin është regjistruar votuesi në ekstraktin nga lista e votuesve.

Votuesit që votojnë jashtë vendit marrin ftesën e votimit nga përfaqësia diplomatike-konsullore.

Votuesit që votojnë në entin për zbatimin e sanksioneve penale marrin ftesën e votimit nga ministria kompetente për drejtësinë.

Votuesit në shërbimin ushtarak, ushtrimin ushtarak ose në shkollim pranë njësisve ose institucioneve të Ushtrisë së Serbisë në ditën e votimit, marrin ftesën e votimit nga ministria kompetente për mbrojtjen.

Rregullat e përgjithshme për punën këshillit të vendvotimit

Neni 87

Këshilli i vendvotimit duhet të jetë në vendvotim një orë para hapjes së vendvotimit si dhe gjatë votimit dhe konfirmimit të rezultateve të votimit.

Anëtarë të këshillit të vendvotimit dhe zëvendësi i tij mund të jenë të pranishëm njëkohësisht në vendvotim, ose mund të ndërrohen.

Kompletimi dhe saktësia e materialit zgjedhor

Neni 88

Këshillit të vendvotimit, jo më vonë se 24 orë para ditës së votimit, i dorëzohet numri i duhur i fletëvotimeve, fleta kontrolluese, kutia e votimit, lista përmbledhëse zgjedhore, formulari i procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit, formulari i procesverbalit të vëzhguesve të punës së këshillit të vendvotimit, sprej për shënimin e gishtit të votuesit, llamba UV dhe materialet e tjera të nevojshme për zbatimin e votimit në vendvotim.

Para fillimit të votimit, këshilli i vendvotimit verifikon kompletimin dhe saktësinë e materialit zgjedhor.

Veprimi në situatat kur materiali zgjedhor është i paplotë ose i pasaktë

Neni 89

Nëse materiali i dorëzuar zgjedhor është i paplotë ose i pasaktë, këshilli i vendvotimit e njofton menjëherë komisionin zgjedhor lokal.

Nëse mungon ekstrakti nga lista e votuesve, kutia e votimit, fleta kontrolluese dhe materialet e tjera pa të cilat nuk mund të zbatohet votimit, këshilli i vendvotimit nuk e hap vendvotimin.

Nëse këshilli i vendvotimit merr më pak fletëvotime se sa është numri i votuesve të regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve, është i detyruar të hapë vendvotimin.

Këshilli i vendvotimit nuk duhet të shtojë votuesit në ekstraktin nga lista e votuesve, as në rastin kur mendon se një person është lënë jashtë listët si pasojë e gabimit të organit kompetent për përpilimin e ekstraktit nga lista e votuesve.

Rregullimi i vendvotimit

Neni 90

Dhoma e votimit, duke filluar nga hyrja, duhet të rregullohet në mënyrë të tillë që vendet për kryerjen e veprimeve zgjedhore të vendosen me renditje të mëposhtme: Vendi ku anëtari i këshillit të vendvotimit bën verifikim me llambë UV, vendi kur përcaktohet identiteti i votuesit, vendi ku gjendet ekstrakti nga lista e votuesve, vendi ku anëtari i këshillit të vendvotimit shënon gishtin e votuesit me sprej, vendi ku dorëzohen fletëvotimet, vendi ku janë vendosur paravanet dhe vendi ku është vendosur kutia e votimit.

Për rregullimin e vendvotimit kujdeset komisioni zgjedhor lokal, këshilli i vendvotimit dhe qeverisja e komunës ose qytetit.

Për rregullimin e vendvotimeve jashtë vendit kujdesen këshilli i vendvotimit dhe ministria kompetente për punët e jashtme.

Për rregullimin e vendvotimeve në entet për zbatimin e sanksioneve penale kujdesen këshilli i vendvotimit dhe ministria kompetente për drejtësinë.

Rregullat më të detajuara për rregullimin e dhomës së votimit përcaktohen nga Komisioni Zgjedhor i Republikës.

Kohëzgjatja e votimit në vendvotim

Neni 91

Votimi vazhdon pa ndërprerje nga ora 7.00 deri në 20.00.

Nëse hapja e vendvotimit shtyhet ose nëse votimi ndërpritet për më shumë se një orë, votimi zgjatet për aq kohë sa është shtyrë hapja e vendvotimit, ose për aq kohë sa ka zgjatur ndërprerja e votimit.

Vendvotimi mbyllet para orës 20.00 kur të votojnë të gjithë votuesit e regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve, ndërsa rezultatet e votimit në këtë vendvotim nuk duhet të komunikohen publikisht dhe nuk duhet të shpallen në vendvotim para orës 20.00.

Komisioni Zgjedhor i Republikës, duke u kujdesur për diferencën në zonat kohore, përcakton kohën e fillimit dhe përfundimit të votimit në vendvotime jashtë vendit, në mënyrë që votimi të zgjasë 13 orë dhe të përfundojë jo më vonë se në orën 20.00 sipas kohës në Republikën e Serbisë.

Rezultatet e votimit në vendvotime jashtë vendit nuk duhet të komunikohen në publik dhe nuk duhet të shpallen në vendvotim përpara se të përfundojë votimi në Republikën e Serbisë.

Saktësia e kutisë së votimit

Neni 92

Këshilli i vendvotimit në praninë e votuesit të parë në vendvotim verifikon nëse kutia e votimit është e saktë dhe e zbrazët dhe kjo shënohet në fletën kontrolluese.

Fleta kontrolluese nënshkruhet nga votuesi i parë në vendvotim dhe jo minimalisht një anëtar i këshillit të vendvotimit.

Këshilli i vendvotimit në praninë e votuesit të parë në vendvotim hedh fletën kontrolluese të plotësuar dhe të nënshkruar në kutinë e votimit e cila vulloset më pas.

Rregullsia e kutisë së votimit nuk mund të kontrollohet në prani të votuesit për të cilin, pas kontrollimit me llambën UV, është konstatuar se ka votuar në një vendvotim tjetër, i cili nuk ka dokumentin publik të vlefshëm për verifikim të identitetit,

i cili nuk është regjistruar në ekstraktet nga lista e votuesve dhe i cili është anëtar i këshillit të vendvotimit në atë vendvotim.

Votimi në vendvotim

Neni 93

Këshilli i vendvotimit ia dorëzon fletëvotimin votuesit për të cillin verifikohet me llambën UV se nuk ka votuar në vendvotim tjetër, i verifikohet identiteti nëpërmjet letërnjoftimit të tij ose dokumentit tjetër të përshtatshëm publik me fotografi dhe numrin personal të identifikimit (p.sh. Dokumenti i udhëtimit, akreditimi ushtarak dhe dokumentet e tjera në përputhje me udhëzimin e Komisionit Zgjedhor të Republikës) dhe se është i regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve.

Votuesi për të cilin konstatohet pas verifikimi me llambë UV se ka gjurmët e bojës UV në gisht, mund të votojë nëse paraqet vërtetimin se është anëtar i këshillit të vendvotimit.

Kur anëtari përgjegjës i këshillit të vendvotimit e qarkon numrin rendor me të cilin është regjistruar votuesi në ekstraktin nga lista e votuesve dhe kur votuesi nënshkruhet në ekstraktin nga lista e votuesve, këshilli i vendvotimit ia shënon gishtin tregues të dorës së djathtë, ose gishtin tjetër të përshtatshëm, me sprej i cili mbetet si shenjë jo më pak se 24 orë, dhe ia dorëzon një fletëvotim.

Votuesi e plotëson fletëvotimin prapa paravanit të vendosur në mënyrë që të sigurohet fshehtësia e plotë e votimit.

Votuesi, pasi ta plotësojë fletëvotimin, e palos atë në mënyrë që të mos duket se si është plotësuar dhe e hedh atë në kutinë e votimit.

Udhëzimi i votuesve

Neni 94

Pasi votuesit t'i dorëzohet fletëvotimi, këshilli i vendvotimit është i detyruar ta udhëzojë atë që të votojë për një listë zgjedhore duke qarkuar numrin rendor para emrit të listës zgjedhore, se votimi është i fshehtë dhe se bëhet prapa paravanit, si dhe që fletëvotimi duhet palosur pas votimit në mënyrë të mos duket se si është plotësuar dhe se hidhet i palosur në kutinë e votimit.

Këshilli i vendvotimit është i detyruar ta njoftojë veçanërisht votuesin se votimi është i lirë dhe se askush nuk ka të drejtë ta pengojë ose ta detyrojë atë për të votuar, ose ta thërrasë në përgjegjësi sepse ka votuar ose nuk ka votuar ose të kërkojë nga ai të shprehet pse dhe kë ka votuar.

Garancitë e veçanta për votën e lirë dhe të fshehtë

Neni 95

Në vendvotim mund të jenë të pranishëm aq votues sa ka paravane.

Këshilli i vendvotimit është i detyruar që të bëjë lërë një distancë të përshtatshme midis pravaneve dhe t'i vendosë ato në një distancë të përshtatshme nga anëtarët e këshillit të vendvotimit dhe vëzhguesit në mënyrë që votuesit e tjerë, anëtarët e këshillit të vendvotimit dhe vëzhguesit të mos kenë mundësi ta shohin votuesin duke plotësuar fletën e votimit.

Këshilli i vendvotimit është i detyruar të kujdeset veçanërisht që askush t'i mos afrohet paravanit teksa votuesi është duke plotësuar fletëvotimin.

Nuk lejohet që anëtarët e këshillit të vendvotimit, votuesit e tjerë, përfaqësuesit e vëzhguesve ose cilido person tjetër t'i sugjerojë votuesit se kë të votojë.

Nuk lejohet që një person të votojë në vend të personit tjetër.

Votimi jashtë vendvotimit

Neni 96

Votuesit i cili nuk mund të votojë në vendvotim, si pasojë e sëmundjes së rëndë, moshës së shtyrë ose aftësisë së kufizuar, mund t'i mundësohet votimi jashtë vendvotimit por në zonën që përfshin vendvotimi, nëse e njofton komisionin zgjedhor lokal jo më herët se 72 orë para ditës së votimit dhe jo më vonë se në orën 11.00 të ditës së votimit, ose këshillin e vendvotimit në ditën e votimit, jo më vonë se në orën 11.00.

Komisioni zgjedhor lokal para hapjes së vendvotimeve shpall në ueb-faqen e tyre numrin total të votuesve të zonës që kanë njoftuar deri më ditën e votimit se duan të votojnë jashtë vendvotimit.

Këshilli i vendvotimit cakton tre anëtarë (komisionerët e këshillit të vendvotimit) të emëruar me propozim të propozuesve të ndryshëm të autorizuar, të cilët do të shkojnë te votuesi i cili voton jashtë vendvotimit për ta verifikuar identitetin e tij, për të kryer kontrollin me llambë UV dhe për t'ia dorëzuar vërtetimin për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit.

Kur votuesi i cili voton jashtë vendvotimit nënshkruan vërtetimin për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit, ua dorëzon atë komisionerëve të këshillit të vendvotimit, të cilët më pas ia shënojnë me sprej gishtin tregues të dorës së djathtë, ose gishtin tjetër të përshtatshëm, dhe ia dorëzojnë fletëvotimin, listën përmbledhëse zgjedhore dhe një zarf të veçantë në të cilin ai do të vendosë fletëvotimin e plotësuar.

Komisionerët e këshillit të vendvotimit ia shpjegojnë mënyrën e votimit votuesit i cili voton jashtë vendvotimit dhe largohen nga ambienti në të cilin ndodhet ai.

Pasi votuesi që voton jashtë vendvotimit plotëson fletëvotimin, ai e palos atë dhe e vendos në një zarf të veçantë të cilin e vulosin komisionerët e këshillit të vendvotimit në praninë e tij dhe bashkë me vërtetimin për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit e vendosim atë në zarfin zyrtar.

Menjëherë pas kthimit në vendvotim, komisionerët e këshillit të vendvotimit ia dorëzojnë zarfin zyrtar këshillit të vendvotimit i cili e hap atë dhe kontrollon nëse ka vërtetim të nënshkruar për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit dhe nëse ka, këshilli i vendvotimit e qarkon numrin rendor të votuesit në ekstraktin nga lista e votuesve dhe në vendin e dedikuar për nënshkrimin e votuesit vihet shënimi se votuesi ka votuar jashtë vendvotimit, hapet zarfi i vulosur, nxirret fletëvotimi i palosur dhe vendoset në kutinë e votimit.

Nëse në zarfin zyrtar nuk ka vërtetim për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit ose nëse vërtetimi nuk është i nënshkruar, konsiderohet se votuesi nuk ka votuar, ndërsa zarfi i veçantë me fletëvotimin nuk hapet, por vihet në thesin e materialit zgjedhor bashkë me fletëvotimet e papërdorura.

Votim me ndihmës

Neni 97

Votuesi i cili si pasojë e analfabetizmit, shikimit të dëmtuar, aftësive të kufizuara ose të një arsyeje tjetër, nuk është në gjendje ta plotësojë vetë fletëvotimin, ka të drejtë të votojë në vendvotim me ndihmën e ndihmësit të cilin e cakton vetë që t'i plotësojë fletëvotimin ashtu siç i thotë votuesi.

E drejta për të votuar me ndihmën e ndihmësit të cilin e cakton vetë, i takon edhe votuesit që voton jashtë vendvotimit, nëse si pasojë e analfabetizmit, shikimit të

dëmtuar, aftësive të kufizuara ose të një arsyeje tjetër, nuk është në gjendje ta plotësojë vetë fletëvotimin.

Sigurimi i rendit në vendvotim

Neni 98

Këshilli i vendvotimit është i detyruar që të kujdeset për sigurimin e rendit në vendvotim.

Nëse shkelet rendi në vendvotim, këshilli i vendvotimit mund të ndërpresë votimin menjëherë deri sa të vihet rendi përsëri.

Rendi në vendvotim konsiderohet i shkelur sidomos kur në vendvotim ose drejtpërdrejt para vendvotimit:

1) rrinë persona të cilët nuk kanë të drejtë e as detyrë në lidhje me zbatimin e zgjedhjeve;

2) incizojnë dhe fotografojnë ngjarjet në vendvotim në mënyrë të paautorizuar;

3) duke përdorur telefonat celularë ose mjetet e tjera të lidhjes në mënyrë të paautorizuar japin njoftimet për ngjarjet në vendvotim, dhe sidomos për identitetin e personave të cilët kanë dalë ose nuk kanë dalë në zgjedhjet;

4) bëhen listat e votuesve të cilët kanë dalë ose nuk kanë dalë në zgjedhjet jashtë evidencës zyrtare në ekstraktin nga lista e votuesve;

5) shpallin simbolet e partisë politike ose paraqitësit të listës së shpallur zgjedhore, si dhe materialet e tjera zgjedhore të propagandës.

Anëtarët e këshillit të vendvotimit të cilët janë të ngarkuar me ekstraktin nga lista e votuesve mund të shënojnë në një fletë të veçantë një vizë për çdo votues që ka dalë në votim dhe në këtë mënyrë të mbajnë evidencën e pjesëmarrjes.

Nëse mbahet evidenca për pjesëmarrjen në një vendvotim të caktuar, të dhënat për numrin e votuesve të cilët kanë dalë në zgjedhjet duhet të jenë në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit të vendvotimit.

Në kuptimin e dispozitave të këtij ligji i cili rregullon mbajtjen e rendit në vendvotim, vendvotimi nënkupton ambientin në të cilin kryhet votimi, dhe nëse në njërin objekt gjenden disa ambiente votimi, i gjithë objekti konsiderohet vendvotim.

Përfundimi i votimit në vendvotim

Neni 99

Në kohën e mbylljes së vendvotimit, këshilli i vendvotimit njofton të gjithë votuesit të ndodhur në vendvotim ose drejtpërdrejtë para vendvotimit, se mund të votojnë.

Këshilli i vendvotimit duhet të përcaktojë një anëtar i cili do ta përcaktojë numrin e votuesve të cilët ndodhen në vendvotim në kohën e mbylljes së vendvotimit dhe renditjen e votimit të tyre, si dhe të qëndrojë mbrapa votuesit të fundit të konstatuar, në mënyrë që të shënojë kështu fundin e radhës dhe të presë që të votojnë të gjithë votuesit që presin në radhë për të votuar.

Votim në situatat e veçanta

Neni 100

Kur si pasojë e fatkeqësisë natyrale, epidemisë ose arsyeve të tjera votimi nuk mund të zbatohet sipas rregullave të këtij ligji në disa vendvotime pa u cenuar siguria dhe shëndeti i votuesve, Komisioni Zgjedhor i Republikës, pas marrjes së

mendimit nga organet kompetente shtetërore, përcakton rregullat e veçanta sipas të cilëve formohen këshillat e vendvotimit, kryhet dorëzimi i materialit zgjedhor ose zbatohet votimi në këto vendvotime.

Komisioni Zgjedhor i Republikës në asnjë rast nuk mund të formojë këshillin e vendvotimit me më pak se tre anëtarë, dhe nuk mund të devijojë nga rregullat e këtij ligji që kanë të bëjnë me: përcaktimin e saktësisë dhe kompletimit të materialit zgjedhor, veprimin në situatat kur materiali zgjedhor është i paplotë ose i pasaktë, rregullimin e vendvotimit, kontrollin e saktësisë së kutisë së votimit, votimit në vendvotim, udhëzimin e votuesve, garancitë e veçanta për fshehtësinë e votimit dhe mbajtjen e rendit në vendvotim.

4 Përcaktimi i rezultateve të votimit në vendvotim

Vendi i përcaktimit të rezultateve të votimit

Neni 101

Këshilli i vendvotimit përcakton rezultatet e votimit në vendvotim.

Nëse rezultati i votimit nuk mund të përcaktohet në vendvotim pa u rrezikuar siguria dhe shëndeti i anëtarëve të këshillit të vendvotimit si dhe siguria e materialit zgjedhor, Komisioni Zgjedhor i Republikës mund të caktojë zhvendosjen e materialit zgjedhor në një vend tjetër me qëllim që të përcaktohet rezultati i votimit atje.

Nëse materiali zgjedhor zhvendoset, këshilli i vendvotimit është i detyruar që të vulosë vrimën për hedhjen e fletëvotimeve në kutinë e votimit, si dhe të vendosë fletëvotimet e papërdorura dhe ekstraktin nga lista e votuesve në zarfet e veçanta të cilat vulosen më pas.

Procedura e përcaktimit të rezultateve të votimit

Neni 102

Këshilli i vendvotimit përcakton numrin e votuesve që dolën në zgjedhjet duke numëruar votuesit e nënshkruar në ekstraktin nga lista e votuesve dhe shënimet në ekstraktin nga lista e votuesve për votuesit që kanë votuar jashtë vendvotimit.

Pas përcaktimit të numrit të votuesve të regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve dhe numrit të votuesve që dolën në zgjedhjet, këshilli i vendvotimit numëron fletëvotimet e papërdorura dhe më pas verifikon nëse kutia e votimit ishte e vulosur dhe e saktë gjatë gjithë kohës së votimit, e hap kutinë e votimit dhe verifikon nëse ajo përmban fletën kontrolluese të plotësuar dhe nënshkruar.

Këshilli i vendvotimit i ndan të gjithë fletëvotimet nga kutia e votimit në fletëvotimet e vlefshme dhe të pavlefshme, dhe më pas përcakton numrin e fletëvotimeve të pavlefshme.

Fletëvotimet e vlefshme ndahen nga këshilli i vendvotimit sipas listave zgjedhore dhe përcaktohet numri i votave që ka marrë çdo listë zgjedhore.

Fletëvotimi i vlefshëm dhe i pavlefshëm

Neni 103

Fletëvotimi i pavlefshëm është ai fletëvotim që nuk është plotësuar, ose i ka të qarkuara numrat rendorë të dy ose më shumë listave zgjedhore, si dhe çdo fletëvotim tjetër i plotësuar në mënyrë që nuk mund të konstatohet me siguri se cilën listë zgjedhore e ka votuar votuesi.

Fletëvotimi i vlefshëm është ai fletëvotim që ka të qarkuar numrin rendor para emrit të një liste zgjedhore, si dhe fletëvotimi i plotësuar në mënyrë që mund të konstatohet me siguri se kë ka votuar votuesi.

Procesverbali i punës së këshillit të vendvotimit

Neni 104

Procesverbali i punës së këshillit të vendvotimit hartohet në një formular të caktuar i cili plotësohet në gjashtë kopje.

Në komunat ose qytetet ku gjuha e pakicës kombëtare është në përdorimin zyrtar në ditën e shpalljes së zgjedhjeve, përveç formularit për punën e këshillit të vendvotimit i cili do të printohet në gjuhën serbe dhe në alfabetin cirilik, do të hartohet edhe formulari i procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit në gjuhën dhe alfabetin e pakicës kombëtare në të njëjtën formë dhe madhësi të shkronjave.

Kopja e parë e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit i dorëzohet Komisionit Zgjedhor të Republikës, e dyta komisionit zgjedhor lokal, e treta shpallet në vendvotim për qasje publike, ndërsa tre kopje të mbetura të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit u dorëzohen përfaqësuesve të listave zgjedhore që kanë fituar numrin më të lartë të votave në vendvotim.

Përmbajtja e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit

Neni 105

Këshilli i vendvotimit shënon në Procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit: Numrin e votuesve të shënuar në ekstraktin nga lista e votuesve, numrin e votuesve që dolën në zgjedhjet, numrin e fletëvotimeve në kutinë e vendvotimit, numrin e fletëvotimeve të pavlefshme, numrin e fletëvotimeve të vlefshme dhe numrin e votave që ka marrë secila listë zgjedhore.

Procesverbali i punës së këshillit të vendvotimit përmban edhe faktet e tjera të rëndësishme për ecurinë dhe përcaktimin e rezultateve të votimit në vendvotim, duke përfshirë të dhënat për kohën e hapjes dhe mbylljes së vendvotimit, për kontrollin e saktësisë së kutisë së votimit dhe plotësimin dhe nënshkrimin e fletës kontrolluese, për kontrollin e saktësisë dhe vulosjes së kutisë së votimit si dhe për praninë e fletës kontrolluese, për ndërprerjen eventuale të votimit dhe shkeljen e rendit në vendvotim, si dhe kundërshtimet e anëtarëve të këshillit të vendvotimit.

Procesverbali i punës së këshillit të vendvotimit nënshkruhet nga anëtarët e këshillit të vendvotimit, ose zëvendësit e tyre.

Dorëzimi i materialit zgjedhor pas mbylljes së vendvotimit

Neni 106

Pas përcaktimit të rezultateve të votimit, këshilli i vendvotimit pa vonese dhe jo më vonë se 12 orë pas mbylljes së vendvotimit ia dorëzon komisionit zgjedhor lokal kopjen e parë dhe të dytë të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit, formularin e procesverbalit të vëzhguesve të punës së këshillit të vendvotimit, ekstraktin nga lista e votuesve, zarfet e vulosura që përmbajnë fletën kontrolluese, fletëvotimet e papërdorura, fletëvotimet e pavlefshme dhe të vlefshme, si dhe materialet e tjera zgjedhore.

Materialin zgjedhor e dorëzon kryetari i këshillit të vendvotimit ose zëvendësi i tij.

Materialin zgjedhor e marrin të paktën dy anëtarë të komisionit zgjedhor lokal të emëruar me propozim të propozuesve të ndryshëm.

Gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor mund të jenë të pranishëm të gjithë anëtarët e këshillit të vendvotimit.

Materiali zgjedhor nga vendvotimet jashtë vendit transferohen në Komision Zgjedhor të Republikës pa vonesë, në të njëjtën mënyrë siç dorëzohen dërgesat diplomatike.

Garancitë e veçanta për përfaqësuesit listët zgjedhore të opozitës në këshillin e vendvotimit

Neni 107

Anëtari, ose zëvendës anëtari i këshillit të vendvotimit i emëruar me propozimin e listës zgjedhore të opozitës ka të drejtë të jetë i përfshirë në të gjitha aktivitetet e këshillit të vendvotimit, dhe sidomos në pjesëmarrjen në dorëzimin e materialit zgjedhor, ndarjen dhe numërimin e fletëvotimeve, plotësimin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit dhe kontrollin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor.

Kryetari i këshillit të vendvotimit është i detyruar t'i nxisë anëtarët dhe zëvendës anëtarët e këshillit të vendvotimit të emëruar me propozim të listës zgjedhore të opozitës që të kontrollojnë veçanërisht disa veprime zgjedhore siç janë: kontrolli i rregullsisë së kutisë së votimit, ndarja e fletëvotimeve në të vlefshmet dhe të pavlefshmet dhe numërimi i votave të marra nga listat zgjedhore.

Kur përcaktohen komisionerët e këshillit të vendvotimit për zbatimin e votimit jashtë vendvotimit, të paktën një komisioner duhet të jetë përfaqësuesi i listët zgjedhore të opozitës.

Nëse Komisioni Zgjedhor i Republikës parashikon rregullat e veçanta për formimin e këshillave të vendvotimit për zbatimin e votimit në situatat e veçanta, këto rregullat e veçanta duhet të parashikojnë emërimin e së paku një të trete të anëtarëve të këshillit të vendvotimit me propozim të listave zgjedhore të opozitës.

5 Përcaktimi i rezultateve të zgjedhjeve

Kontrolli i procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit

Neni 108

Gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor pas përfundimit të votimit, përfaqësuesit e këshillit të vendvotimit dhe të komisionit zgjedhor lokal janë të detyruar të kontrollojnë procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit dhe të konstatojnë gabimet eventuale në plotësimin e procesverbalit, si dhe të përpilojnë një raport për këtë.

Nëse gjatë kontrollit të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit është bërë edhe qasja në materialin zgjedhor, në raportin e kontrollit të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit shënohet gjendja e faktit e përcaktuar me qasjen në materialin zgjedhor.

Në raportin e kontrollit të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit konstatohet nëse ka kundërshtime të anëtarëve të këshillit të vendvotimit dhe të vëzhguesve të punës së këshillit të vendvotimit.

Procesverbalet e punës së këshillave të vendvotimit që kanë zbatuar votimin jashtë vendit kontrollohen dhe korrigjohen nga Komisioni Zgjedhor i Republikës.

Komisioni Zgjedhor i Republikës i publikon të gjitha procesverbalet të punës së këshillit të vendvotimit në ueb-faqe, dhe nëse është korrigjuar gabimi në plotësimin e punës së këshillit të vendvotimit, publikohet edhe vendimi për korrigjimin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit.

Procedura me gabimet e lehta

Neni 109

Nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit ka gabime të dukshme në plotësimin e këtij procesverbali (gabime të lehta), komisioni zgjedhor lokal në bazë të raportit për kontrollin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit merr vendimin për korrigjimin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit.

Gabimet e lehta janë:

1) nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit nuk është shënuar numri i votuesve të regjistruar në listën e votuesve ose është shënuar numri i gabuar;

2) nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit nuk është shënuar numri i votuesve që kanë dalë në zgjedhjet, dhe rezultatet e tjera janë të sakta nga ana logjiko-llogaritëse;

3) nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit është shënuar numri më i lartë i votuesve që kanë dalë në zgjedhjet sesa numri i votuesve të regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve dhe rezultatet e tjera janë të sakta nga ana logjiko-llogaritëse;

4) nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit nuk është shënuar numri total i fletëvotimeve në kutinë e votimit, dhe rezultatet e tjera janë të sakta nga ana logjiko-llogaritëse;

5) nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit nuk është shënuar numri i fletëvotimeve të vlefshme, dhe shuma e numrit të fletëvotimeve të pavlefshme dhe numrit të votave individuale që ka marrë çdo listë zgjedhore është e barabartë me numrin e fletëvotimeve në kutinë e votimit.

Procedura me gabimet e rënda

Neni 110

Nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit ka gabime të rënda logjiko-llogaritëse (gabime të rënda), përfaqësuesit e këshillit të vendvotimit dhe të komisionit zgjedhor lokal janë të detyruar të bëjnë qasje në materialin zgjedhor gjatë kontrollit të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit.

Komisioni zgjedhor lokal në bazë të raportit për kontrollin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit merr vendimin për korrigjimin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit, vendimin me të cilin konstatohet se në një vendvotim të caktuar nuk mund të përcaktohen rezultatet e votimit ose vendimin me të cilin anulohet votimi në vendvotim sipas detyrës zyrtare.

Në veçanti, gabimet e rënda janë:

1) Nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit është shënuar numri më i lartë i fletëvotimeve sesa numri i votuesve që dolën në zgjedhjet;

2) Nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit numri i votave që ka marrë çdo listë zgjedhore nuk është i barabartë me numrin e fletëvotimeve të vlefshme, dhe shuma e fletëvotimeve të pavlefshme dhe të vlefshme është e barabartë me numrin e fletëvotimeve në kutinë e votimit;

3) Nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit shuma e numrit të fletëvotimeve të pavlefshme dhe numrit të votave që ka marrë çdo listë zgjedhore është më e madhe sesa numri i votuesve të regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve;

4) nëse numri i fletëvotimeve të vlefshme të shënuara në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit nuk është i barabartë me shumën e numrit të votave individuale që ka marrë çdo listë zgjedhore, dhe shuma e fletëvotimeve të pavlefshme dhe të votave individuale që ka marrë çdo listë zgjedhore është e barabartë me numrin e fletëvotimeve në kutinë e votimit;

5) nëse në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit nuk është shënuar numri i fletëvotimeve të pavlefshme, dhe shuma e numrit të votave individuale që ka marrë çdo listë zgjedhore është e barabartë ose më e vogël se numri i fletëvotimeve në kutinë e votimit;

6) nëse numri i fletëvotimeve të vlefshme të shënuara në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit nuk është i barabartë me diferencën e numrit të fletëvotimeve në kutinë e votimit dhe numrit të fletëvotimeve të vlefshme, dhe shuma e numrit të votave individuale që ka marrë çdo listë zgjedhore është e barabartë ose më e vogël se numri i fletëvotimeve në kutinë e votimit.

Kontrolli i procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit që kryhet nga anëtarët dhe zëvendës anëtarët e Komisionit Zgjedhor të Republikës dhe të komisioneve zgjedhore lokale

Neni 111

Anëtari dhe zëvendës anëtari i Komisionit Zgjedhor të Republikës dhe të komisionit zgjedhor lokal kanë të drejtë të kryejnë qasje në materialin zgjedhor të çdo vendvotimi brenda 48 orëve nga përfundimi i votimit, dhe të kontrollojnë nëse ka votuar votuesi i cili i ka dorëzuar adresën e tij, numrin unik të identifikimit dhe pëlqimin e shkruar për këtë lloj kontrolli.

Kërkesë për kontrollin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit për mostër

Neni 112

Me kërkesën e cila paraqitet brenda 48 orëve nga mbyllja e vendvotimit, Komisioni Zgjedhor i Republikës vendos që komisioni zgjedhor lokal me qasjen në materialin zgjedhor të kryejë kontrollin e procesverbalit të punës së këshillave të vendvotimit me jo më shumë se 5% të vendvotimeve në territorin e komisionit zgjedhor lokal.

Kërkesa për kontrollin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit për mostër mund të paraqitet nga lista e shpallur zgjedhore e cila ka marrë më shumë se 2% të votave sipas rezultateve paraprake dhe lista e shpallur zgjedhore opozicionare e pakicës e cila ka marrë më shumë se 1% të votave sipas rezultateve paraprake të zgjedhjeve.

Nëse kërkohet kontrolli i procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit për mostër për më shumë se 5% të vendvotimeve, kontrolli i procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit kryhet në ato vendvotime ku janë regjistruar më shumë votues.

Kundër vendimit për hedhjen poshtë ose refuzimin e kërkesës për kontrollin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit për mostër, paraqitësi i kërkesës mund t'i paraqesë ankesën Komisionit Zgjedhor të Republikës brenda 48 orëve nga publikimi i këtij vendimi në ueb-faqe.

Kundër vendimit për miratimin e kërkesës për kontrollin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit për mostër, paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore mund t'i paraqesë ankesën Komisionit Zgjedhor të Republikës brenda 48 orëve nga publikimi i këtij vendimi në ueb-faqe.

Kontrolli i procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit për mostër

Neni 113

Komisioni zgjedhor lokal përpilon raportin për kontrollin e kryer të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit dhe e publikon atë në ueb-faqen e tij.

Nëse nga pikëpamja e votave që ka marrë një listë e caktuar zgjedhore konstatohet në bazë të kontrollit të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit se ka devijime midis përmbajtjes së materialit zgjedhor dhe procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit më shumë se 10% në të gjitha vendvotimet e kontrolluara nga territori i komisionit zgjedhor lokal, Komisioni Zgjedhor i Republikës përcakton kontrollimin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit në 5% të tjera të vendvotimeve.

Nëse nga pikëpamja e votave që ka marrë një listë e caktuar zgjedhore konstatohet pas kontrollit të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit se ka devijime midis përmbajtjes së materialit zgjedhor dhe procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit më shumë se 10% në të gjitha vendvotimet e kontrolluara nga territori i komisionit zgjedhor lokal, Komisioni Zgjedhor i Republikës përcakton kontrollimin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit në 5% të tjera të vendvotimeve.

Kontrolli i procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit për mostër përfundon kur Komisioni Zgjedhor i Republikës të miratojë raportin e komisionit zgjedhor lokal në të cilin konstatohet se në mostrën e kontrolluar nuk ka devijime më shumë se 10% midis përmbajtjes së materialit zgjedhor dhe procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit, pra raportin për rezultatet e kontrollit të të gjitha vendvotimeve nga territori i komisionit zgjedhor lokal.

Pasojat juridike të kontrollit të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit

Neni 114

Nëse gjatë kontrollit të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit që kryhet nga anëtarët dhe zëvendës anëtarët e Komisionit Zgjedhor të Republikës dhe të komisioneve zgjedhore lokale, si dhe gjatë kontrollit të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit për mostër konstatohet mospërputhja midis përmbajtjes së materialit zgjedhor dhe procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit, komisioni zgjedhor lokal merr vendimin për korrigjimin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit.

Nëse gjatë kontrollit të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit që kryhet nga anëtarët dhe zëvendës anëtarët e Komisionit Zgjedhor të Republikës dhe të komisioneve zgjedhore lokale, si dhe gjatë kontrollit të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit për mostër konstatohet ndonjë parregullsi e cila përbën arsye për të anuluar votimin në vendvotim sipas detyrës zyrtare, komisioni zgjedhor lokal merr vendimin për anulimin e votimit në vendvotim.

Nëse ekziston një dyshim i bazuar se mospërputhja e madhe midis përmbajtjes së materialit zgjedhor dhe procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit vjen si pasojë e aktivitetit të qëllimshëm i cili synon përcaktimin e rezultatit të pavërtetë të zgjedhjeve, Komisioni Zgjedhor i Republikës është i detyruar të ngritë kallëzimin penal pranë prokurorisë publike kundër anëtarëve të këshillit të vendvotimit.

Pamundësia për të përcaktuar rezultatet e votimit në vendvotim

Neni 115

Komisioni zgjedhor lokal sipas detyrës zyrtare merr vendimin me të cilin konstatohet se në vendvotimin e caktuar nuk mund të përcaktohen rezultatet e votimit:

- 1) nëse votimi në këtë vendvotim nuk është mbajtur ose nëse është ndërprerë dhe nuk ka vazhduar;
- 2) nëse nuk marrin procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit;
- 3) nëse procesverbali i dorëzuar i punës së këshillit të vendvotimit nuk është nënshkruar nga të paktën tre anëtarë të këshillit të vendvotimit;
- 4) Nëse ka gabime të rënda logjiko-llogaritëse në plotësimin e procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit të cilat nuk mund të korrigjoheshin pas qasjes në tërë materialin zgjedhor nga vendvotimi.

Vendimi me të cilin konstatohet se në vendvotim jashtë vendit nuk mund të përcaktohen rezultatet e votimit merret nga Komisioni Zgjedhor i Republikës.

Vendimi me të cilin konstatohet se në vendvotim nuk mund të përcaktohen rezultatet e votimit publikohet në ueb-faqe.

Paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore dhe votuesi i regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve në këtë vendvotim mund t'i paraqesin ankesë Komisionit Zgjedhor të Republikës kundër vendimit me të cilin konstatohet se në vendvotim nuk mund të përcaktohen rezultatet e votimit, brenda 72 orëve nga publikimi i këtij vendimi në ueb-faqe.

Anulimi i votimit në vendvotim sipas detyrës zyrtare

Neni 116

Komisioni zgjedhor lokal sipas detyrës zyrtare merr vendimin për anulimin e votimit në vendvotim nëse përcaktohet:

- 1) se numri i fletëvotimeve në kutinë e votimit është më i lartë sesa numri i votuesve që dolën në zgjedhjet;
- 2) se këshilli i vendvotimit i ka mundësuar votimin personit i cili nuk është i regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve;
- 3) se në kutinë e votimit nuk ka fletë kontrolluese, ose që fleta kontrolluese nuk është plotësuar ose nuk është nënshkruar nga votuesi i parë dhe të paktën një anëtar i këshillit të vendvotimit;
- 4) se shuma e numrit të fletëvotimeve të papërdorura dhe të fletëvotimeve në kutinë e votimit është më e madhe se numri i fletëvotimeve të marra nga këshilli i vendvotimit.

Vendimi për anulimin e votimit sipas detyrës zyrtare në vendvotim jashtë vendit merret nga Komisioni Zgjedhor i Republikës.

Vendimi për anulimin e votimit në vendvotim sipas detyrës zyrtare publikohet në ueb-faqe.

Paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore dhe votuesi i regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve në këtë vendvotim mund t'i paraqesin ankesë Komisionit Zgjedhor të Republikës kundër vendimit me të cilin anulohet votimi në vendvotim sipas detyrës zyrtare, brenda 72 orëve nga publikimi i këtij vendimi në ueb-faqe.

Përsëritja e votimit

Neni 117

Votimi në vendvotim përsëritet nëse konstatohet se në këtë vendvotim nuk mund të përcaktohen rezultatet e votimit ose nëse është anuluar votimi në vendvotim.

Vendimi për votim të përsëritur në vendvotim merret nga Komisioni Zgjedhor i Republikës brenda tre ditëve nga dita e publikimit të vendimit në ueb-faqe me të cilin konstatohet se në vendvotim mund të përcaktohen rezultatet e votimit, ose të vendimit që anulon votimin në këtë vendvotim.

Nëse paraqitet mjete juridik kundër vendimit me të cilin konstatohet se në vendvotim nuk mund të përcaktohen rezultatet e votimit, ose vendimit me të cilin anulohet votimi në vendvotim, afati për marrjen e vendimit për përsëritjen e votimit në këtë vendvotim llogaritet nga dita kur Komisionit Zgjedhor të Republikës i është dorëzuar vendimi për mjetin juridik.

Votimi i përsëritur zbatohet brenda dhjetë ditëve nga dita e marrjes së vendimit për përsëritjen e votimit.

Këshilli i vendvotimit për zbatimin e votimit të përsëritur

Neni 118

Komisioni zgjedhor lokal emëron këshillin e ri për zbatimin e votimit të përsëritur.

Nëse paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore nuk e ka propozuar anëtarin ose zëvendës anëtarin e këshillit të vendvotimit në përbërje të zgjeruar në vendvotimin ku përsëritet votimi, i lind e drejta për t'i propozuar ata për zbatimin e votimit të përsëritur.

Raporti përmbledhës për rezultatet e votimit

Neni 119

Komisioni zgjedhor lokal brenda 96 orëve nga mbyllja e vendvotimeve dhe pa vonesë, përpilon dhe ia dorëzon Komisionit Zgjedhor të Republikës raportin përmbledhës për rezultatet e votimit për të gjitha vendvotimet në territorin e tij, i cili përmban numrin e votuesve të regjistruar në listën e votuesve, numrin e votuesve që dolën në zgjedjet, numrin e fletëvotimeve në kutitë e votimit, numrin e fletëvotimeve të pavlefshme, numrin e fletëvotimeve të vlefshme dhe numrin e votave që mori çdo listë zgjedhore.

Raporti përmbledhës për rezultatet e votimit jashtë vendit miratohet nga Komisioni Zgjedhor i Republikës.

Nëse është ushtruar mjete juridik për shkak të parregullsive gjatë zbatimit të votimit në vendvotim dhe nëse është ushtruar mjete juridik kundër vendimit i cili konstaton se në vendvotim nuk mund të përcaktohen rezultatet e votimit, ose vendimit me të cilin anulohet votimi në vendvotim, afati për miratimin dhe dorëzimin e raportit përmbledhës për rezultatet e votimit llogaritet nga dita kur komisionit zgjedhor lokal i janë dorëzuar vendimet për të gjitha mjetet e paraqitura juridike.

Nëse në disa vendvotime zbatohet votimi i përsëritur, afati për miratimin dhe dorëzimin e raportit përmbledhës për rezultatet e votimit llogaritet nga mbyllja e vendvotimit të fundit në të cilin është përsëritur votimi, ose nga dita kur komisionit zgjedhor lokal i janë dorëzuar vendimet për të gjitha mjetet eventuale juridike të paraqitura në lidhje me votimin e përsëritur.

Nëse është paraqitur kërkesa për kryerjen e kontrollit të punës së këshillit të vendvotimit për mostër, afati për miratimin dhe dorëzimin e raportit përmbledhës për rezultatet e votimit llogaritet nga përfundimi i kontrollit të procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit.

Paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore dhe votuesi i shënuar në listën e votuesve në vendvotimin që ndodhet në territorin e komisionit zgjedhor lokal mund t'i paraqesin ankesë Komisionit Zgjedhor të Republikës kundër raportit përmbledhës për rezultatet e votimit, në afatin prej 72 orëve nga publikimi i raportit përmbledhës në ueb-faqe.

Paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore dhe votuesi i shënuar në listën e votuesve në vendvotimin që ndodhet jashtë vendit mund t'i paraqesin ankesë Komisionit Zgjedhor të Republikës kundër raportit përmbledhës për rezultatet e votimit jashtë vendit, në afatin prej 72 orëve nga publikimi i raportit përmbledhës në ueb-faqe.

Anulimi i raportit përmbledhës për rezultatet e votimit sipas detyrës zyrtare

Neni 120

Komisioni Zgjedhor i Republikës sipas detyrës zyrtare merr vendimin për anulimin e raportit përmbledhës për rezultatet e votimit nëse konstaton se komisioni zgjedhor lokal nuk ka përcaktuar rezultatet e votimit në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Nëse komisioni zgjedhor lokal nuk e miraton në kohë raportin përmbledhës për rezultatet e votimit ose nëse anulohet raporti përmbledhës për rezultatet e votimit, Komisioni Zgjedhor i Republikës mund të marrë tërë materialin zgjedhor dhe mund të miratojë raportin përmbledhës për rezultatet e votimit nëse këtë e lejon natyra e gjërave dhe nëse gjendja e konstatuar e faktit ofron një bazë të besueshme për këtë.

Raporti total për rezultatet e zgjedhjeve

Neni 121

Komisioni Zgjedhor i Republikës brenda 96 orëve nga pranimi i të gjitha raporteve përmbledhëse për rezultatet e votimit miraton dhe publikon raportin total për rezultatet e zgjedhjeve për të gjitha vendvotimet, i cili përmban numrin e votuesve të regjistruar në listën e votuesve, numrin e votuesve që dolën në zgjedhjet, numrin e votuesve që kanë votuar, numrin e fletëvotimeve të pavlefshme dhe të vlefshme, numrin e votave që ka marrë secila listë zgjedhore dhe numrin e mandateve të fituara të çdo liste zgjedhore.

Numri i votuesve që kanë votuar përcaktohet në bazë të numrit të fletëvotimeve që gjenden në kutitë e votimit.

Nëse është paraqitur mjeti juridik kundër raportit përmbledhës për rezultatet e votimit, afati për miratimin dhe publikimin e raportit total për rezultatet e zgjedhjeve llogaritet nga dita kur Komisionit Zgjedhor të Republikës i është dorëzuar vendimi sipas mjetit juridik.

Paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore dhe votuesi mund t'i paraqesin ankesë Komisionit Zgjedhor të Republikës kundër raportit total për rezultatet e zgjedhjeve, brenda 72 orëve nga shpallja e raportit total në ueb-faqe.

Publikimi i raportit për rezultatet e zgjedhjeve

Neni 122

Komisioni Zgjedhor i Republikës publikon rezultatet e votimit në ueb-faqe për çdo vendvotim si dhe të gjitha raportet përmbledhës për rezultatet e votimit.

Raporti total për rezultatet e zgjedhjeve publikohet në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë”.

Përpunimi statistikor i të dhënave

Neni 123

Përpunimi statistikor i të dhënave përfshin hedhjen e rezultateve të votimit nga procesverbali i punës së këshillit të vendvotimit në databazën e rezultateve të zgjedhjeve nga të gjitha vendvotimet, kontrollin logjiko-llogaritëse të rezultateve të hedhura në procesverbalet e punës së këshillave të vendvotimit dhe hartimin e raporteve për nevojat e Komisionit Zgjedhor të Republikës dhe të komisioneve zgjedhore lokale.

Organi i Republikës kompetent për punët e statistikës përcakton personat të cilët kryejnë punët e përpunimit statistikor të të dhënave në selinë e Komisionit Zgjedhor të Republikës dhe të komisioneve zgjedhore lokale.

Paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore mund të deklarojë pranë Komisionit Zgjedhor të Republikës personin i cili ka të drejtë të jetë i pranishëm gjatë përpunimit statistikor të të dhënave në Komisionin Zgjedhor të Republikës dhe komisionet zgjedhore lokale.

Menjëherë pas përpunimit statistikor, të dhënat për rezultatet e votimit në vendvotimet publikohen në ueb-faqen, duke filluar nga të dhënat e vendvotimit të parë të përpunuar, deri te publikimi i rezultateve totale të zgjedhjeve.

Komisioni Zgjedhor i Republikës gjatë seancës përcakton rezultatet paraprake të zgjedhjeve për të gjitha vendvotimet e përpunuara brenda 24 orëve nga mbyllja e vendvotimeve.

Komisioni Zgjedhor i Republikës cakton rregullat për përpunimin statistikor të të dhënave.

6 Ndërprerja e veprimtarisë zgjedhore

Arsyeja e ndërprerjes së veprimtarisë zgjedhore

Neni 124

Komisioni Zgjedhor i Republikës sipas detyrës zyrtare merr vendimin për ndërprerjen e veprimtarive zgjedhore kur si pasojë e gjendjes së luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme ose shpalljes së situatës së jashtëzakonshme për territorin e Republikës së Serbisë nuk është i mundur zhvillimi i zgjedhjeve ose vështirësohet në mënyrë të konsiderueshme.

Vendimi për ndërprerjen e veprimtarive zgjedhore prodhon efekt juridik në ditën e publikimit të tij në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë”.

Pasojat e ndërprerjes së veprimtarisë zgjedhore

Neni 125

Me ndërprerjen e veprimtarive zgjedhore ndërpriten të gjitha afatet për kryerjen e veprimtarive zgjedhore.

Gjatë ndërprerjes së veprimtarive zgjedhore, organet për zbatimin e zgjedhjeve nuk mund të ndërmarrin asnjë veprim në procedurën zgjedhore.

Efekt i juridik i veprimtarisë zgjedhore që ndërmerret gjatë ndërprerjes së veprimtarive zgjedhore mund të shfaqet vetëm kur të vazhdojë procedura zgjedhore.

Përfundimisht, gjatë ndërprerjes së veprimtarive zgjedhore votuesit mund të nënshkruajnë deklaratat për mbështetjen e listës zgjedhore.

Vazhdimi i veprimtarisë zgjedhore

Neni 126

Kur të zgjidhen arsyet e ndërprerjes së veprimtarisë zgjedhore, Komisioni Zgjedhor i Republikës sipas detyrës zyrtare merr vendimin e vazhimit të veprimtarisë zgjedhore dhe e publikon atë në "Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë".

Afatet që janë ndërprerë si pasojë e ndërprerjes së veprimtarisë zgjedhore vazhdojnë ditën e publikimit të vendimit për vazhdimin e veprimtarisë zgjedhore në "Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë".

Propozim për ndërprerje, ose vazhdim të veprimtarisë zgjedhore

Neni 127

Propozimi për ndërprerje, ose vazhdim të veprimtarisë zgjedhore mund të paraqitet nga partia politike dhe paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore.

Komisioni Zgjedhor i Republikës është i detyruar të marrë vendimin për propozimin për ndërprerje ose vazhdim të veprimtarisë zgjedhore dhe ta publikojë atë brenda 24 orëve nga pranimi i tij.

VI SHPËRNDARJA, DHËNIA DHE NDËRPRERJA E MANDATEVE

Censusi zgjedhor

Neni 128

Në shpërndarjen e mandateve mund të marrin pjesë vetëm listat zgjedhore që kanë marrë jo më pak se 3% të votave të votuesve që kanë votuar.

Nëse asnjë listë zgjedhore nuk ka marrë 3% të votave të votuesve që kanë votuar, atëherë të gjitha listat zgjedhore që kanë marrë votat mund të marrin pjesë në shpërndarjen e mandateve.

Sistemi i koeficientit më të lartë

Neni 129

Mandatet shpërndahen në mënyrë që numri total i votave të fituara nga lista zgjedhore e cila merr pjesë në shpërndarjen e mandateve pjesëtohet me çdo numër nga 1 deri 250.

Koeficientet e marra ndahen sipas madhësisë në mënyrë që listës zgjedhore t'i takojnë aq mandate sa ka koeficiente të saja ndër 250 koeficiente më të larta të të gjitha listave zgjedhore që marrin pjesë në këtë shpërndarje.

Nëse dy ose më shumë lista zgjedhore marrin koeficientet e njëjta në bazë të të cilave shpërndahet mandati, përparësia i jepet asaj liste që ka fituar numrin më të lartë të votave.

Nëse një liste të caktuar i takojnë më shumë mandate se sa ka kandidatë për deputetët popullorë, mandati që nuk i jepet kësaj liste i jepet listës zgjedhore së cilës i takon koeficienti më i lartë i radhës për të cilin nuk është dhënë mandati.

Dhënia e mandateve

Neni 130

Komisioni Zgjedhor i Republikës brenda dhjetë ditëve nga dita e publikimit të raportit total për rezultatet e zgjedhjeve u jep mandatet kandidatëve për deputetët popullorë sipas renditjes së tyre në listën zgjedhore, duke filluar nga kandidati i parë nga lista zgjedhore, dhe lëshon vërtetimin e zgjedhjes për deputetin popullor.

Ndërprerja e mandatit

Neni 131

Deputetit popullor i ndërpritet mandati kur të konfirmohen mandatet për dy të tretat e deputetëve popullorë nga legjislatura e ardhshme të Ansamblesë Popullore.

Para se të konfirmohen mandatet për dy të tretat e deputetëve popullorë nga legjislatura e ardhshme e Ansamblesë Popullore, deputetit popullor i ndërpritet mandati:

- 1) nëse vdes;
- 2) nëse është i privuar nga aftësia për të punuar me vendim gjykate të formës së prerë, ose nëse është privuar pjesërisht nga aftësia për të punuar me vendim gjykate të formës së prerë si i paaftë për të zbatuar të drejtën elektorale;
- 3) nëse është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë me burgim prej të paktën gjashtë muajsh;
- 4) nëse ka marrë një funksion i cili sipas ligjit dhe Kushtetutës nuk mund të ushtrohet njëkohësisht me funksionin e deputetit popullor;
- 5) nëse ka humbur shtetësinë e Republikës së Serbisë;
- 6) nëse jep dorëheqje.

Deputetit popullor i ndërpritet mandati kur ndodh rasti i cili përbën arsye për ndërprerjen e mandatit.

Dorëheqja e deputetit popullor

Neni 132

Dorëheqja e deputetit popullor paraqitet me shkrim, ndërsa nënshkrimi i paraqitësit duhet të jetë e vulosur në përputhje me ligjin që rregullon vulosjen e nënshkrimeve.

Dorëheqja paraqitet personalisht në Ansamblenë Popullore brenda tri ditëve nga dita e vulosjes së nënshkrimit të paraqitësit.

Dorëheqja ka vlefshmëri të plotë vetëm nëse nënshkrimi i deputetit popullor është vulosur pasi i është konfirmuar mandati.

Dorëheqja nuk mund të revokohet.

Deputetit popullor i ndërpritet mandati më ditën e dhënies së dorëheqjes.

Konstatimi i ndërprerjes së mandatit

Neni 133

Ansambleja Popullore konstaton ndërprerjen e mandatit të deputetit menjëherë pas pranimit të njoftimit për arsyet e ndërprerjes së mandatit, në seancën e cila është duke u zhvilluar, ose në seancën e parë të radhës.

Plotësimi i vendit bosh të deputetit

Neni 134

Mandati i ndërprerë i një deputeti, para se të konfirmohen mandatet për dy të tretat të deputetëve popullorë nga legjislatura e ardhshme e Ansamblesë Popullore, i jepet me vendim kandidatit të parë të radhës nga e njëjta listë zgjedhore, të cilit nuk i është dhënë mandati i deputetit popullor brenda shtatë ditëve nga dita kur është konstatuar ndërprerja e mandatit.

Nëse në listën zgjedhore nuk ka kandidatë të cilëve nuk u është dhënë mandati, vendi bosh i deputetit plotësohet duke i dhënë mandatin kandidatit të parë nga lista tjetër zgjedhore e cila ka koeficientin më të lartë për të cilin nuk është dhënë mandati i deputetit popullor.

Plotësimi i vendit bosh të deputetit nga lista zgjedhore e koalicionit

Neni 135

Mandati i ndërprerë i një deputeti nga lista zgjedhore e koalicionit, para se të konfirmohen mandatet për dy të tretat të deputetëve popullorë nga legjislatura e ardhshme e Ansamblesë Popullore, i jepet kandidatit të parë të radhës nga e njëjta parti politike në këtë listë zgjedhore, të cilit nuk i është dhënë mandati i deputetit popullor.

Nëse në listën zgjedhore nuk ka kandidatë nga e njëjta parti politike të cilëve nuk u është dhënë mandati, vendi bosh i deputetit plotësohet duke i dhënë mandatin kandidatit të parë nga lista zgjedhore të cilit nuk i është dhënë mandati, nëse në marrëveshjen e koalicionit nuk është parashikuar dhënia e mandatit kandidatit të parë të radhës të një partie të caktuar politike të cilit nuk i është dhënë mandati i deputetit popullor.

Dhënia e përsëritur e mandatit deputetit popullor

Neni 136

Deputeti popullor i cili ka dhënë dorëheqje me qëllim të marrjes së funksionit të anëtarit të Qeverisë, pas mbarimit të funksionit të anëtarit të Qeverisë mund të paraqesë kërkesën për dhënie të përsëritur të mandatit në të njëjtën legjislaturë të Ansamblesë Popullore nëse ekziston vendi bosh i deputetit për listën zgjedhore nga e cila është zgjedhur deputeti.

VII RREGULLAT E VEÇANTA PËR LISTAT ZGJEDHORE TË PAKICAVE KOMBËTARE

Lista zgjedhore e pakicës kombëtare

Neni 137

Lista zgjedhore e pakicës kombëtare në kuptimin e këtij ligji, konsiderohet ajo listë zgjedhore për të cilën Komisioni Zgjedhor i Republikës ka vërtetuar se qëllimi kryesor i paraqitjes së saj është përfaqësimi i interesave të pakicës kombëtare, si dhe mbrojtja dhe përmirësimi i të drejtave të pjesëtarëve të pakicës kombëtare, në përputhje me standardet ndërkombëtare juridike.

Komisioni Zgjedhor i Republikës me një vendim të veçantë përcakton se lista zgjedhore ka pozitën e listës zgjedhore të pakicës kombëtare në kuptimin e këtij ligji njëkohësisht gjatë shpalljes, dhe me propozimin e paraqitësit të listës që paraqitet bashkë me listën zgjedhore.

Komisioni Zgjedhor i Republikës mund të kërkojë mendimin e këshillit kompetent të pakicës kombëtare për faktin nëse një listë e caktuar zgjedhore mund të ketë pozitën e listës zgjedhore të pakicës kombëtare.

Paraqitësi i listës zgjedhore të pakicës kombëtare mund të jetë vetëm partia politike e pakicës kombëtare ose koalicioni i përbërë vetëm nga partitë politike e pakicave kombëtare.

Ndalimi i mashtrimit të ligjit

Neni 138

Komisioni Zgjedhor i Republikës me vendim refuzon propozimin për t'i përcaktuar pozitën e listës zgjedhore të pakicës kombëtare një liste të caktuar zgjedhore, nëse mbartësi i listës ose kandidati për deputetin popullor në këtë listë zgjedhore është një person për të cilin dihet gjerësisht se është anëtar i një partie tjetër politike e cila nuk është partia e politike e pakicës kombëtare ose nëse përcaktohen rrethanat e tjera të cilat pa dyshim tregojnë qëllimin për të mashtruar ligjin.

Pozita e listës zgjedhore të pakicës kombëtare gjatë kandidimit

Neni 139

Komisioni Zgjedhor i Republikës mund ta shpallë listën zgjedhore të pakicës kombëtare nëse paraqitësi i listës zgjedhore dorëzon 5.000 deklaratat të vulosura të votuesve për mbështetjen e listës zgjedhore.

Pozita e listës zgjedhore të pakicës kombëtare gjatë shpërndarjes së mandateve

Neni 140

Lista zgjedhore e pakicës kombëtare merr pjesë në shpërndarjen e mandateve edhe në rastet kur merr më pak se 3% të votave të votuesve që kanë votuar.

Kur shpërndahen mandatet me sistemin e koeficientit më të lartë, koeficientet e listave zgjedhore të pakicave kombëtare që kanë marrë më pak se 3% të votave zmadhohen për 35%.

VIII PREZANTIMI I PARAQITËSVE TË LISTAVE TË SHPALLURA ZGJEDHORE DHE KANDIDATËVE NGA LISTAT E SHPALLURA ZGJEDHORE

E drejta e prezantimit të paraqitësit të listës së shpallur zgjedhore

Neni 141

Paraqitësit e listave të shpallura zgjedhore dhe kandidatet nga listat e shpallura zgjedhore kanë të drejtë të përfaqësohen pa pagesë dhe në mënyrë të barabartë në programet e shërbimeve publike mediatike në mënyrën e parashikuar me këtë ligj.

Sigurimi i përfaqësimit të paraqitësit të listës zgjedhore

Neni 142

Shërbimet publike mediatike janë të detyruara që t'u sigurojnë të gjithë paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore dhe kandidatëve nga listat e shpallura zgjedhore që të prezantojnë programet e tyre zgjedhore pa pagesë dhe pa diskriminim.

Paanshmëria në prezantimin e paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore

Neni 143

Shërbimet publike mediatike në përmbajtjet e tyre programore të prezantimit janë të detyruara që t'u sigurojnë paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore dhe kandidatëve të tyre kushtet për prezantim të paanshëm, të drejtë dhe të balancuar.

Marrëveshja për numrin dhe kohëzgjatjen e emisioneve për prezantimin e paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore

Neni 144

Nga dy përfaqësues të shërbimit publik mediatik të Republikës, Qeverisë dhe partive politike që kanë deputetët popullorë e përcaktojnë me marrëveshje numrin dhe kohëzgjatjen e emisioneve për prezantimin e paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore.

Marrëveshja për numrin dhe kohëzgjatjen e emisioneve për prezantimin e paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore lidhet jo më vonë se pesë ditë pas hyrjes në fuqi të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve, dhe publikohet pa vonesë në ueb-faqe.

Shërbimi publik mediatik i Republikës, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Qeverisë, partive politike që kanë deputetët popullorë dhe paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore, cakton rregullat për prezantimin e paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore, programeve zgjedhore dhe kandidatëve për deputetët popullorë.

Komiteti mbikëqyrës për fushatën zgjedhore

Neni 145

Në zbatimin e zgjedhjeve, mbikëqyrja e përgjithshme mbi veprimtarinë e partive politike, paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore, kandidatëve për deputetët popullorë dhe shërbimeve publike mediatike gjatë aktiviteteve elektorale zbatohet nga Komiteti mbikëqyrës për fushatën zgjedhore (në tekstin e mëtejshëm: Komiteti mbikëqyrës).

Komiteti mbikëqyrës ka dhjetë anëtarë, të emëruar nga Ansambleja Popullore, ku gjysma prej tyre janë me propozim të Qeverisë dhe gjysma tjetër me propozim të grupeve të deputetëve në Ansamblenë Popullore, nga rreshtat e punonjësve të shquar publikë.

Anëtarët e Komitetit mbikëqyrës nuk mund të jenë anëtarët e organeve të partive politike.

Kryetarin e Komitetit mbikëqyrës e zgjedhin vetë anëtarët e Komitetit mbikëqyrës me votim të fshehtë.

Kompetencat e Komitetit mbikëqyrës

Neni 146

Komiteti mbikëqyrës:

- 1) ndjek aktivitetet parazgjedhore dhe tregon parregullsitë eventuale në veprimtarinë e partive politike, kandidatëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurën zgjedhore;
- 2) kontrollon veprimtarinë e shërbimeve publike mediatike në zbatimin e dispozitave të këtij ligji të cilat i referohen sigurimit të kushteve për prezantim të paanshëm, të drejtë dhe të balancuar të paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore dhe kandidatëve nga listat e shpallura zgjedhore;

3) propozon masat për respektimin e barazisë së kandidatëve në prezantimin e programeve të tyre;

4) i drejtohet publikut me qëllim të mbrojtjes së integritetit moral të personalitetit të kandidatit;

5) jep paralajmërime në lidhje me veprimtarinë e partive politike, kandidatëve dhe mjeteve të informimit publik e cila cenon fushatën zgjedhore dhe barazinë e të gjitha të drejtave të të gjithë kandidatëve;

6) miraton rregulloren e tij.

Nëse ndonjë pjesëmarrës në fushatën zgjedhore me sjelljen e tij bën thirrje për dhunë, përhap urrejtje kombëtare, fetare ose racore ose bën nxitje për pabarazinë gjinore, Komiteti mbikëqyrës pa vonesë jep iniciativën për nisjen e procedurës para organeve kompetente të shtetit.

Nëse marrëveshja për numrin dhe kohëzgjatjen e emisioneve për prezantimin e paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore nuk lidhet brenda afatit të parashikuar, Komiteti mbikëqyrës përcakton numrin dhe kohëzgjatjen e emisioneve për prezantimin e paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore.

Mjetet për punën e Komitetit mbikëqyrës sigurohen nga buxheti i Republikës së Serbisë.

Kushtet për punën e Komitetit mbikëqyrës sigurohen nga Ansambleja Popullore.

IX MBROJTJA E SË DREJTËS ZGJEDHORE

Mjetet juridike në zbatimin e zgjedhjeve

Neni 147

Mjetet juridike në zbatimin e zgjedhjeve janë kërkesa për anulimin e votimi në vendvotim, kundërshtimi dhe ankesa.

Kërkesë për anulimin e votimit në vendvotim

Neni 148

Paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore ka të drejtë të paraqesë kërkesën për anulimin e votimit në vendvotim për shkak të parregullsive gjatë zhvillimit të votimit brenda 72 orëve nga mbyllja e vendvotimit.

Votuesi ka të drejtë brenda 72 orëve nga mbyllja e vendvotimit të paraqesë kërkesën për anulimin e votimit në vendvotimin në të cilin është regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve nëse këshilli i vendvotimit në mënyrë të pabazuar e parandalon që të votojë, ose nëse i është cenuar e drejta e votës së lirë dhe të fshehtë në vendvotim.

Komisioni zgjedhor lokal vendos për kërkesën për anulimin e votimit në vendvotim, ndërsa Komisioni Zgjedhor i Republikës vendos për kërkesën për anulimin e votimit në vendvotim jashtë vendit.

Organi kompetent për vendimmarrje mbi kërkesën për anulimin e votimit në vendvotim është i detyruar të marrë vendimin mbi këtë kërkesë dhe ta publikojë atë në ueb-faqe, brenda 72 orëve nga pranimi i kërkesës.

Përmbajtja e kërkesës për anulimin e votimit në vendvotim

Neni 149

Kërkesa për anulimin e votimit në vendvotim duhet të jetë e kuptueshme dhe të përmbajë të gjitha gjërat e nevojshme në mënyrë që të veprohet sipas saj, dhe veçanërisht:

- 1) shënimin e organit kompetent për të marrë vendimin sipas kërkesës;
- 2) emrin, mbiemrin, numrin unik personal të identifikimit, vendin dhe adresën e vendbanimit, numrin e telefonit dhe adresën për marrjen e postës elektronike të votuesit nëse paraqitësi i kërkesës është votues;
- 3) emrin e listës së shpallur zgjedhore, emrin e paraqitësit të listës së shpallur zgjedhore dhe emrin, mbiemrin, numrin unik personal të identifikimit, vendin dhe adresën e vendbanimit, numrin e telefonit dhe adresën për marrjen e postës elektronike të personit të autorizuar që të përfaqësojë paraqitësin e listës së shpallur zgjedhore nëse kërkesa paraqitet nga paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore;
- 4) nënshkrimin e paraqitësit të kërkesës;
- 5) objektin e kërkesës, dhe në veçanti vendvotimin e saktë (emri i komunës ose qytetit ku ndodhet vendvotimi dhe numrin e vendvotimit) si dhe përshkrimin e saktë të veprimeve duke shënuar se ku dhe nga kush është bërë ky veprim;
- 6) faktet mbi të cilat bazohet kërkesa;
- 7) provat.

Nëse kërkesa për anulimin e votimit nuk është e kuptueshme ose është e paplotë, organi kompetent për marrjen e vendimit për kërkesën në fjalë merr vendimin për refuzimin e kërkesës.

Rregullat e përgjithshme për të drejtën e kundërshtimit

Neni 150

Paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore ka të drejtë të kundërshtojë vendimin e marrë, veprimin e ndërmarrë dhe mosmarrjen e vendimit ose mosveprimin në zhvillimin e zgjedhjeve, nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Kundërshtimi mund të bëhet ndaj vendimit, veprimit ose mosmarrjes së vendimit, ose mosveprimit për të cilin parashikohet një mjet tjetër juridik.

Paraqitësi i listës zgjedhore, partia politike, grupi i deputetëve, kandidati për deputetin popullor, votuesi dhe personi emri i të cilit është në emrin e listës zgjedhore ose të paraqitësit të listës zgjedhore, mund të paraqesin kundërshtimin e tyre kur kjo parashikohet në këtë ligj.

Përmbajtja e kundërshtimit

Neni 151

Kundërshtimi duhet të jetë i kuptueshëm dhe të përmbajë të gjitha gjërat e nevojshme në mënyrë që të veprohet sipas tij, dhe veçanërisht:

- 1) shënimin se kundërshtimi i paraqitet Komisionit Zgjedhor të Republikës;
- 2) emrin, mbiemrin, numrin unik personal të identifikimit, vendin dhe adresën e vendbanimit, numrin e telefonit dhe adresën për marrjen e postës elektronike të paraqitësit të kundërshtimit nëse paraqitësi i kundërshtimit është person fizik;
- 3) emrin dhe selinë e paraqitësit të kundërshtimit dhe emrin, mbiemrin, numrin unik personal të identifikimit, vendin dhe adresën e vendbanimit, numrin e

telefonit dhe adresën për marrjen e postës elektronike të personit të autorizuar që të përfaqësojë paraqitësin e kundërshtimit nëse paraqitësi i kundërshtimit është person juridik;

4) emrin e listës së shpallur zgjedhore, emrin e paraqitësit të listës së shpallur zgjedhore dhe emrin, mbiemrin, numrin unik personal të identifikimit, vendin dhe adresën e vendbanimit, numrin e telefonit dhe adresën për marrjen e postës elektronike të personit të autorizuar që të përfaqësojë paraqitësin e listës së shpallur zgjedhore nëse kundërshtimi paraqitet nga paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore;

5) nënshkrimin e paraqitësit të kundërshtimit;

6) objektin e kundërshtimit, dhe në veçanti emrin e saktë të vendimit duke shënuar marrësin e vendimit, datën e marrjes dhe numrin me të cilin është regjistruar vendimi nëse vendimi kontestohet me kundërshtim, ose përshkrimin e saktë të veprimit duke shënuar kush dhe ku është ndërmarrë ky veprim nëse kundërshtimi konteston një veprim gjatë procedurës zgjedhore;

7) faktet mbi të cilat bazohet kundërshtimi;

8) provat.

Nëse kundërshtimi nuk është i kuptueshëm ose është i paplotë, Komisioni Zgjedhor i Republikës merr vendimin për refuzimin e tij.

Afati për paraqitjen e kundërshtimit

Neni 152

Kundërshtimi mund të paraqitet brenda 72 orëve nga publikimi i vendimit, ose ndërmarrja e veprimeve që konsiderohen të parregullta nga paraqitësi, nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë ligj.

Kundërshtimi për faktin se vendimi nuk është marrë brenda afatit të përcaktuar me ligj ose akt nënligjor të Komisionit Zgjedhor të Republikës, gjegjësisht veprimi i ndërmarrë mund të paraqitet brenda 72 orëve nga përfundimi i afatit në të cilin duhej të merrej vendimi, gjegjësisht në të cilin është dashur të ndërmerret veprimi, përveç nëse me këtë ligj është përcaktuar ndryshe.

Kompetenca për vendimmarrje sipas kundërshtimit

Neni 153

Vendimet për kundërshtimin merren nga Komisioni Zgjedhor i Republikës.

Komisioni Zgjedhor i Republikës është i detyruar të marrë vendimin për kundërshtimin dhe ta publikojë atë brenda 72 orëve nga pranimi i tij.

Kundërshtimi dhe vendimi për kundërshtimin publikohen nga Komisioni Zgjedhor i Republikës në ueb-faqe.

Kundërshtimi ndaj vendimit për kërkesën për anulimin e votimit në vendvotim

Neni 154

Kundër vendimit për hedhjen poshtë ose refuzimin e kërkesës për anulimin e votimit në vendvotim, paraqitësi i kërkesës mund t'i paraqesë kundërshtimin Komisionit Zgjedhor të Republikës brenda 72 orëve nga publikimi i këtij vendimi në ueb-faqe.

Kundërshtimi për faktin se vendimi për anulimin e votimit në vendvotim nuk është marrë në afatin e parashikuar, mund të paraqitet brenda 72 orëve nga përfundimi i afatit në të cilin është dashur të merret vendimi për kërkesën në fjalë.

Kundër vendimit për miratimin e kërkesës për anulimin e votimit në vendvotim, paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore mund t'i paraqesë kundërshtimin Komisionit Zgjedhor të Republikës brenda 72 orëve nga publikimi i këtij vendimi në ueb-faqe.

Kundërshtimi ndaj vendimit për kërkesën për anulimin e votimit në vendvotim paraqitet përmes komisionit zgjedhor lokal, i cili është i detyruar të paraqesë kundërshtimin dhe të gjitha shkresat e çështjes në Komisionin Zgjedhor të Republikës brenda 72 orëve nga pranimi i kundërshtimit.

Komisioni Zgjedhor i Republikës merr vendimin sipas ankesës dhe e publikon atë në ueb-faqe brenda 72 orëve nga pranimi i kundërshtimit me shkresat.

Vendimi i Komisionit Zgjedhor të Republikës sipas kundërshtimit

Neni 155

Nëse Komisioni Zgjedhor i Republikës e miraton kundërshtimin, ai anulon vendimin e marrë në zbatimin e zgjedhjeve, gjegjësisht veprimin e ndërmarrë në zbatimin e zgjedhjeve.

Kur konstaton se vendimi ndaj të cilit është paraqitur kundërshtimit duhet të anulohet, Komisioni Zgjedhor i Republikës mund të marrë një vendim tjetër në vend të atij të anuluar.

Komisioni Zgjedhor i Republikës kur konstaton se vendimi që ka vendosur për kërkesën për anulimin e votimit në vendvotim duhet të anulohet, mund të vendosë në mënyrë meritore sipas kërkesës për anulimin e votimit në vendvotim nëse natyra e çështjes e lejon atë dhe nëse gjendja faktike e vërtetuar ofron bazë të besueshme për këtë.

Ankesë kundër vendimit të Komisionit Zgjedhor të Republikës për kundërshtimin

Neni 156

Kundër vendimit të Komisionit Zgjedhor të Republikës për refuzimin ose hedhjen poshtë të kundërshtimit, paraqitësi i kundërshtimit mund të paraqesë ankesën pranë Gjykatës Administrative brenda 72 orëve nga publikimi i këtij vendimi në ueb-faqe.

Ankesa për faktin se vendimi për anulimin e votimit në vendvotim nuk është marrë në afatin e parashikuar, mund të paraqitet brenda 72 orëve nga përfundimi i afatit në të cilin është dashur të merret vendimi për kundërshtimin.

Kundër vendimit të Komisionit Zgjedhor të Republikës, i cili pranoi kundërshtimin, paraqitësi i listës së shpallur zgjedhore, paraqitësi i listës zgjedhore, partia politike, grupi parlamentar, kandidati për deputet, votuesi dhe personi emri i të cilit është në emrin e listës zgjedhore ose të parashtruesit të listës zgjedhore mund të paraqesin ankesë në Gjykatën Administrative brenda 72 orëve pas publikimit të këtij vendimi në ueb-faqe, nëse me kundërshtimin e pranuar drejtpërdrejt dëmtohet interesi i tyre juridik.

Verpimi sipas ankesës

Neni 157

Komisioni Zgjedhor i Republikës është i detyruar t'i dorëzojë Gjykatës Administrative ankesën dhe të gjitha shkresat e çështjes brenda 24 orëve nga pranimi i ankesës.

Gjykata Administrative merr vendimin sipas ankesës brenda 72 orëve nga data e pranimit të ankesës me shkresat.

Vendimin e marrë në procedurën sipas ankesës Gjykata Administrative ia dorëzon paraqitësit të ankesës nëpërmjes Komisionit Zgjedhor të Republikës.

Vendimet e Gjykatës Administrative sipas ankesës

Neni 158

Nëse Gjykata Administrative e miraton ankesën, ai anulon vendimin e marrë në zbatimin e zgjedhjeve, gjegjësisht veprimin e ndërmarrë në zbatimin e zgjedhjeve.

Kur konstaton se duhet të anulohet vendimi kundër të cilit është paraqitur ankesa, Gjykata Administrative mund të vendosë në mënyrë meritore sipas kundërshtimit nëse e lejon natyra e çështjes dhe nëse gjendja e konstatuar e fakteve ofron një bazë të besueshme për këtë.

Vendimi i Gjykatës Administrative me të cilin është vendosur në mënyrë meritore për kundërshtimin, e zëvendëson tërësisht vendimin e anuluar.

Vendimi i marrë sipas ankesës në procedurë është i plotfuqishëm dhe kundër tij nuk mund të paraqiten mjetet e jashtëzakonshme juridike të parashikuara me ligjin me të cilin rregullohet kontesti administrativ.

Nëse Gjykata Administrative e miraton ankesën dhe e anulon vendimin e marrë në zhvillimin e zgjedhjeve, gjegjësisht veprimin e ndërmarrë në zhvillimin e zgjedhjeve, merret vendimi përkatës, gjegjësisht ndërmerret masa e duhur jo më vonë se dhjetë ditë nga dita kur Komisioni Zgjedhor i Republikës mori vendimin e Gjykatës Administrative.

Zbatimi i rregullave për procedurën e përgjithshme administrative dhe kontestin administrativ

Neni 159

Dispozitat e ligjit i cili rregullon procedurën e përgjithshme administrative zbatohen në marrjen e vendimit për kërkesën për anulimin e votimit në vendvotim dhe në marrjen e vendimit për kundërshtimin.

Dispozitat e ligjit i cili rregullon kontestin administrativ zbatohen në marrjen e vendimit për ankesën dhe vendimin e Komisionit Zgjedhor të Republikës për kundërshtimin.

Publikimi i mjeteve juridike dhe vendimeve për mjetet juridike

Neni 160

Komisioni Zgjedhor i Republikës publikon të gjitha mjetet juridike dhe vendimet e marra për to në ueb-faqen e tij.

X VËZHGIMI I PUNËS SË ORGANEVE PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE

Aplikimi për vëzhguesin vendor

Neni 161

Një shoqatë e regjistruar në Republikën e Serbisë qëllimet e së cilës arrihen në fushën e zgjedhjeve dhe e cila është e interesuar të vëzhgojë punën e organit për zbatimin e zgjedhjeve mund të paraqesë kërkesë për vëzhgues vendor në Komisionin Zgjedhor të Republikës jo më vonë se shtatë ditë para ditës së votimit.

Aplikimit për vëzhgues vendor i bashkëngjitet lista e përfaqësuesve të vëzhguesit vendor, e cila përmban emrin, mbiemrin, numrin personal të identifikimit dhe zonën e vëzhgimit për çdo përfaqësues të vëzhguesit vendor që aplikon për akreditim.

Përfaqësuesi i vëzhguesit vendor mund të akreditohet si vëzhgues vendor vetëm nëse është shtetas madhor i Republikës së Serbisë, nëse nuk është kandidat për deputet popullor ose anëtar i organit për zbatimin e zgjedhjeve.

Aplikimi për vëzhguesin e huaj

Neni 162

Organizata dhe shoqata e huaj ndërkombëtare, e cilat është e interesuar për monitorimin e punës së organeve të zbatimit të zgjedhjeve, mund të paraqesë kërkesë për vëzhgues të huaj në Komisionin Zgjedhor të Republikës jo më vonë se dhjetë ditë para ditës së votimit.

Aplikimit për vëzhgues të huaj i bashkëngjitet lista e përfaqësuesve të vëzhguesit të huaj, e cila përmban emrin, mbiemrin, numrin e dokumentit të udhëtimit, emrin e shtetit që ka lëshuar dokumentin e udhëtimit si dhe zonën e vëzhgimit për çdo përfaqësues të vëzhguesit të huaj që aplikon për akreditim.

Aplikimi për vëzhgues të huaj shoqërohet me listën e përkthyesve nëse ata shoqërojnë përfaqësuesit e regjistruar të vëzhguesit të huaj, e cila përmban emrin, mbiemrin dhe numrin personal të identifikimit për çdo përkthyes të regjistruar që është shtetas i Republikës së Serbisë, gjegjësisht emri, mbiemri, numri i dokumentit të udhëtimit dhe emri i shtetit që ka lëshuar dokumentin e udhëtimit për çdo përkthyes të regjistruar që është shtetas i një vendi të huaj që aplikon për akreditim.

Aplikimin për vëzhgues të huaj dhe listën e përfaqësuesve të vëzhguesit të huaj dhe të përkthyesve që i shoqërojnë Komisioni Zgjedhor i Republikës i dorëzon pa vonesë ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme, e cila është e detyruar t'i paraqesë mendimin e saj për këtë aplikim Komisionit Zgjedhor të Republikës brenda tri ditëve nga dita e pranimit të aplikimit.

Aplikimi i shtetit të huaj si vëzhgues

Neni 163

Përfaqësuesi i shtetit të huaj të interesuar për të monitoruar punën e organeve për zbatimin e zgjedhjeve mund të paraqesë aplikimin e shtetit të huaj për vëzhgues në ministrinë kompetente për punët e jashtme, jo më vonë se dhjetë ditë para ditës së votimit.

Aplikimit të shtetit të huaj për vëzhgues i bashkëngjitet lista e përfaqësuesve tij, e cila përmban emrin, mbiemrin, numrin e dokumentit të udhëtimit, emrin e shtetit që ka lëshuar dokumentin e udhëtimit si dhe zonën e vëzhgimit për çdo përfaqësues të tij që aplikon për akreditim.

Aplikimi i shtetit të huaj për vëzhgues shoqërohet me listën e përkthyesve nëse ata shoqërojnë përfaqësuesit e regjistruar të tij, e cila përmban emrin, mbiemrin dhe numrin personal të identifikimit për çdo përkthyes që është shtetas i Republikës së Serbisë, gjegjësisht emri, mbiemri, numri i dokumentit të udhëtimit dhe emri i shtetit që ka lëshuar dokumentin e udhëtimit për çdo përkthyes të regjistruar që është shtetas i një vendi të huaj që aplikon për akreditim.

Ministria përgjegjëse për punët e jashtme ia përcjell me mendimin Komisionit Zgjedhor të Republikës aplikimin e shtetit të huaj për vëzhgues si dhe listën e përfaqësuesve dhe të përkthyesve që i shoqërojnë ata, brenda tri ditëve nga dita e marrjes së aplikimit.

Autorizimi i vëzhguesit

Neni 164

Vëzhguesit i cili ka aplikuar për të vëzhguar punën e këshillave të vendvotimit mund t'i lejohet të vëzhgojë punën e të gjitha këshillave të vendvotimit në territorin e një komisioni të caktuar zgjedhor lokal.

Vëzhguesit i cili ka aplikuar për të vëzhguar punën e këshillit të vendvotimit jashtë vendit ose punën e këshillit të vendvotimit në institucionet për ekzekutimin e sanksioneve penale mund t'i lejohet të vëzhgojë punën vetëm të atij këshilli të vendvotimit për të cilin ka aplikuar.

Vëzhguesit i cili ka aplikuar për të vëzhguar punën e komisioneve zgjedhore lokale mund t'i lejohet të vëzhgojë punën e të gjitha komisioneve zgjedhore lokale në territorin e një rrethi administrativ, ose të Qytetit të Beogradit.

Në seancat e Komisionit Zgjedhor të Republikës, të komisionit zgjedhor lokal ose në qendrën e votimit nuk mund të marrin pjesë njëkohësisht dy përfaqësues të së njëjtës shoqatë që është regjistruar si vëzhgues vendor.

Autorizimi dhe identifikimi

Neni 165

Komisioni Zgjedhor i Republikës i lëshon autorizimin e duhur aplikuesit që lejohet të vëzhgojë punën e organit të zbatimit të zgjedhjeve ndërsa përfaqësuesve dhe përkthyesve të tij që e shoqërojnë, u lëshon identifikimin e duhur në të cilin shënohen të dhënat e nevojshme nga lista e bashkangjitur me aplikimin e vëzhguesit.

Autorizimi dhe identifikimi lëshohen brenda tri ditëve nga dita e paraqitjes së aplikimit për vëzhgues, gjegjësisht nga pranimi i mendimit të ministrisë kompetente për punët e jashtme nëse aplikimi i përmbush kushtet e parashikuara në ligj.

Shpenzimet e vëzhgimit të punës së organeve për zbatimin e zgjedhjeve i ngarkohen aplikuesit për vëzhgues.

Pozita e vëzhguesit

Neni 166

Organi për zbatimin e zgjedhjeve është i detyruar t'i mundësojë përfaqësuesit të vëzhguesit dhe përkthyesit i cili e shoqëron që të vëzhgojnë çdo veprimtari zgjedhore në mënyrë të papenguar.

Përfaqësuesi i vëzhguesit dhe përkthyesi i cili e shoqëron janë të detyruar t'i mbajnë identifikimet e tyre në një vend të dukshëm.

Përkthyesi nuk ka të drejtë të jetë i pranishëm në seancën e komisionit zgjedhor dhe në vendvotim pa përfaqësuesin e vëzhguesit të cilin e shoqëron.

Vëzhguesi i punës së komisionit zgjedhor

Neni 167

Përfaqësuesi i vëzhguesit të punës së komisionit zgjedhor është i detyruar të lëvizë brenda autorizimeve të marra.

Komisioni Zgjedhor i Republikës mund t'i marrë akreditimin përfaqësuesit të vëzhguesit të punës së komisionit zgjedhor nëse ai nuk sillet në përputhje me autorizimet e tij.

Vëzhguesi i punës së këshillit të vendvotimit

Neni 168

Përfaqësuesi i vëzhguesit të këshillit të vendvotimit mund të monitorojë punën e këshillit të vendvotimit nga dorëzimi i materialeve zgjedhore para votimit deri në fund të dorëzimit të materialeve zgjedhore pas votimit, duke përfshirë hapjen e kutisë së votimit, numërimin e votave, përcaktimin e rezultateve të votimit, votimin jashtë qendrës së votimit, si dhe rivotimin në atë vendvotim.

Nëse votimi përsëritet në një vendvotim, aplikuesi për vëzhgues ka të drejtë të ndryshojë përfaqësuesit e tij që vëzhgojnë punën e këshillit të vendvotimit, dhe nëse nuk ka pasur përfaqësues të tij në atë vendvotim, ai mund t'i regjistrojë ata me qëllim të monitorimit të punës së këshillit të vendvotimit në zhvillimin e rivotimit.

Përfaqësuesi i vëzhguesit të punës së këshillit të vendvotimit është i detyruar të veprojë sipas rregullave për ruajtjen e rendit në vendvotim.

Këshilli i vendvotimit mund ta largojë përfaqësuesin e vëzhguesit nga qendra e votimit nëse ai nuk respekton rregullat për mbajtjen e rendit në vendvotim, nëse përdor celular ose mjete të tjera të lidhjes dhe komunikimit në qendrën e votimit, dhe veçanërisht. nëse pengon punën e këshillit të vendvotimit.

Për largimin e përfaqësuesit të vëzhguesit dhe arsyet e largimit të tij, këshilli i vendvotimit është i detyruar të njoftojë menjëherë komisionin zgjedhor lokal, ndërsa këshilli i vendvotimit jashtë vendit njofton Komisionin Zgjedhor të Republikës për këtë.

Procesverbali për praninë e përfaqësuesve të vëzhguesve të punës së këshillit të vendvotimit përpilohet në formularin e përcaktuar nga Komision Zgjedhor i Republikës, i cili përmban të dhëna për përfaqësuesit e vëzhguesve që kanë monitoruar punën e këshillit të vendvotimit dhe vërejtjet e tyre eventuale.

XI SHPENZIMET E ZHVILLIMIT TË ZGJEDHJEVE

Neni 169

Mjetet për punën e organeve zgjedhore, materialet zgjedhore dhe shpenzimet e tjera të zbatimit të zgjedhjeve sigurohen nga buxheti i Republikës.

Komisioni Zgjedhor i Republikës përcakton tarifën për punën në organet për zbatimin e zgjedhjeve dhe shpenzimet e tjera të zhvillimit të zgjedhjeve.

XII DISPOZITAT NDËSHKUESE

Shkelja e rregullave për heshtjen zgjedhore

Neni 170

Gjobitet prej 100.000 deri në 600.000 dinarë për kundërvajtje personi juridik i cili 48 orë para ditës së votimit dhe në ditën e votimit para mbylljes së vendvotimeve publikon vlerësimin e rezultateve të zgjedhjeve, prezanton publikisht kandidatët në zgjedhje dhe programet e tyre zgjedhore dhe fton votuesit të votojnë ose të mos votojnë listat e caktuara zgjedhore.

Gjobitet prej 50.000 deri në 150.000 dinarë për kundërvajtje personi përgjegjës në median e cila 48 orë para ditës së votimit dhe në ditën e votimit para mbylljes së vendvotimeve publikon vlerësimin e rezultateve të zgjedhjeve, prezanton publikisht kandidatët në zgjedhje dhe programet e tyre zgjedhore dhe fton votuesit të votojnë ose të mos votojnë listat e caktuara zgjedhore.

Gjobitet prej 20.000 deri në 50.000 dinarë personi përgjegjës në personin juridik i cili 48 orë para ditës së votimit dhe në ditën e votimit para mbylljes së

vendvotimeve publikon në media dhe tubimet publike vlerësimin e rezultateve të zgjedhjeve, prezanton publikisht kandidatët në zgjedhje dhe programet e tyre zgjedhore dhe fton votuesit të votojnë ose të mos votojnë listat e caktuara zgjedhore.

Gjobitet prej 10.000 deri në 40.000 dinarë për kundërvajtje personi fizik i cili 48 orë para ditës së votimit dhe në ditën e votimit para mbylljes së vendvotimeve publikon në media dhe tubimet publike vlerësimin e rezultateve të zgjedhjeve, prezanton publikisht kandidatët në zgjedhje dhe programet e tyre zgjedhore dhe fton votuesit të votojnë ose të mos votojnë listat e caktuara zgjedhore.

Mosdorëzimi i ftesës për votim

Neni 171

Gjobitet prej 20.000 deri në 50.000 dinarë drejtuesi i organit përgjegjës për informimin e votuesve për kohën dhe vendin e votimit nëse nuk ia dorëzon votuesit në kohën e duhur ftesën për të votuar.

Shpалosja e materialit zgjedhor propagandistik në qendrën e votimit

Neni 172

Gjobitet prej 100.000 deri në 400.000 dinarë për kundërvajtje partia politike, koalicioni apo personi tjetër juridik që shfaq simbolet e partisë politike, paraqitësit të listës së shpallur zgjedhore, si dhe materiale të tjera propaganduese zgjedhore në vendvotim ose drejtpërdrejtë përpara vendvotimit.

Gjobitet prej 10.000 deri në 25.000 dinarë për kundërvajtje personi përgjegjës në organizatën politike apo në personin tjetër juridik që shfaq simbolet e partisë politike dhe paraqitësit të listës së shpallur zgjedhore, si dhe materiale të tjera propaganduese zgjedhore në vendvotim ose drejtpërdrejtë përpara vendvotimit.

Gjobitet prej 10.000 deri në 25.000 dinarë për kundërvajtje personi fizik që shfaq simbolet e partisë politike dhe paraqitësit të listës së shpallur zgjedhore, si dhe materiale të tjera propaganduese zgjedhore në vendvotim ose drejtpërdrejtë përpara vendvotimit.

Parandalimi i pjesëmarrjes në punë dhe të ndjekjes së punës së organeve për zbatimin e zgjedhjeve

Neni 173

Gjobitet prej 25.000 deri në 50.000 dinarë për kundërvajtje anëtar i organit për zbatimin e zgjedhjeve i cili pengon një anëtar tjetër në monitorimin dhe pjesëmarrjen në punën e organit për zbatimin e zgjedhjeve, gjegjësisht i cili pengon përfaqësuesin e vëzhguesit të monitorojë punën e organit për zbatimin e zgjedhjeve.

Shkelja e rendit në vendvotim

Neni 174

Gjobitet prej 10.000 deri në 30.000 dinarë për kundërvajtje personi që shkel rendin në vendvotim.

Shkelja e së drejtës për prezantim të paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore dhe kandidateve

Neni 175

Gjobitet prej 50.000 deri në 600.000 dinarë për kundërvajtje shërbimi publik mediatik nëse në programin e tij nuk u siguron të gjithë paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore dhe kandidatëve nga listat e shpallura zgjedhore që të prezantojnë programet e tyre zgjedhore pa pagesë dhe pa diskriminim.

Gjobitet prej 10.000 deri në 30.000 dinarë për kundërvajtje personi përgjegjës në shërbimin publik mediatik nëse në programin e tij nuk u siguron të gjithë paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore dhe kandidatëve nga listat e shpallura zgjedhore që të prezantojnë programet e tyre zgjedhore pa pagesë dhe pa diskriminim.

XIII DISPOZITAT KALUESE DHE PËRFUNDIMTARE

Afati për miratimin e standardeve unike për materialin zgjedhor

Neni 176

Komisioni Zgjedhor i Republikës do të përcaktojë standardet unike për materialin zgjedhor brenda dhjetë ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Afati për themelimin e Komisionit Zgjedhor të Republikës

Neni 177

Ansambleja Popullore formon Komisionin Zgjedhor të Republikës në përputhje me këtë ligj brenda shtatë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Afati për themelimin e Komitetit Mbikëqyrës

Neni 178

Ansambleja Popullore formon Komitetin Mbikëqyrës në përputhje me këtë ligj brenda shtatë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Rritja e përkohshme e numrit të anëtarëve në përbërjen e përhershme të organit për zbatimin e zgjedhjeve

Neni 179

Zgjedhjet e para për deputetë që do të shpallen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji i zhvillon Komisioni Zgjedhor i Republikës, në përbërjen e përhershme të të cilit, përveç presidentit, 16 anëtarëve dhe zëvendësve e tyre të cilët emërohen me propozim të grupeve parlamentare, bëjnë pjesë edhe gjashtë anëtarë të tjerë dhe zëvendësit e tyre të emëruar nga Ansambleja Popullore me propozim të Kryetarit të Ansamblesë, brenda shtatë ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe mandati i tyre zgjat deri në përfundimin e raportit të përgjithshëm për rezultatet e zgjedhjeve.

Në zbatimin e zgjedhjeve të para për deputetët popullorë që do të shpallen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji marrin pjesë komisionet zgjedhore lokale në përbërjen e përhershme të të cilave, përveç anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve që emërohen në përputhje me ligjin që rregullon zgjedhjet lokale, hyn edhe nga një anëtar dhe një zëvendës anëtar, të cilët emërohen nga Komisioni Zgjedhor i Republikës me propozim të Kryetarit të Ansamblesë Popullore dhe mandati i tyre zgjat deri në përfundimin e raportit përmbledhës të rezultateve të votimit.

Në zbatimin e zgjedhjeve të para për deputetët popullorë që do të shpallen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji marrin pjesë këshillat e vendvotimit në përbërjen e përhershme të të cilave, përveç anëtarëve dhe zëvendës anëtarëve që emërohen me rregullat e përgjithshme të këtij ligji, hyn edhe nga një anëtar dhe një zëvendës anëtar që emërohen nga Komisioni Zgjedhor i Republikës me propozim të Kryetarit të Ansamblesë Popullore.

Rregullat që nuk janë më të vlefshme

Neni 180

Më ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushojnë së vlefshmi Ligji për zgjedhjen e deputetëve popullorë ("Fletorja Zyrtare e RS", nr. 35/00, 57/03 – GJ.K, 72/03 – ligji shtetëror, 18/04, 85/05 – ligji shtetëror, 101/05 – ligji shtetëror, 104/09 – ligji

shtetëror, 28/11 – GJ.K, 36/11, 12/20 dhe 68/20) dhe Udhëzimi për formën dhe përmasat e kutisë së votimit („Fletorja zyrtare e RS“, numri 42/00).

Hyrja në fuqi

Neni 181

Ky ligj hyn në fuqi një ditë pas publikimit në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë”.